



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/01/2022

Lënda: *Opinion Amicus Curia, mbi kërkesën e sjellë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, për padinë e paraqitur nga ana e paditëseve, A. A., E. M., H. M. dhe A. M.*

Drejtuar: **Gjyqtar Arbena Ahmetaj**
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

E nderuara kryesuese e trypit gjykues,

Pasi u njohëm me kërkesë-padinë e paraqitur nga ana e shtetaseve, A. A., E. M., H. M. dhe A. M., në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me objekt: ***“Ndryshimin e aktit administrativ, shkresë kthim përgjigje nr.2627/1 datë 15.04.2021 dhe detyrimin e të paditurit për të regjistruar fëmijët H. dhe A. M., binjake të seksit femër, të lindura në 18.01.2021 në Tiranë, dhe për të regjistruar si nëna, paditëset A. A. dhe E. M. me të drejta të barabarta amësie në të njëjtën përbërje familjare”***, ku në pretendimet kryesore të parashtruara në këtë kërkesë-padi, citojmë:

1. Paditëset A. A. dhe E. M. janë të lidhura mes tyre në një bashkim fakti prej më shumë se 10 vitesh, nga ku prej më shumë se 7 vitesh bashkëjetojnë. Ato kanë konceptuar që në fillim jetën dhe familjen së bashku, pavarësisht mungesës në legjislacion të njohjes të së drejtës për martesën, apo bashkëjetesën, mes të njëjtës gjini.
2. Gjatë bashkëjetesës faktike, zgjerimi i familjes nga ana e tyre është dëshiruar dhe realizuar me ardhjen në jetë të 2 fëmijëve binjake, vajza, në datë 18.01.2021, nga shtatëzania e zhvilluar nga ana e shtetases E. M., përmes metodave të inseminimit artificial.
3. Megjithëse, paditëset A. A. dhe E. M. (H. M. dhe A. M.), kanë shprehur vullnetin e tyre për të regjistruar fëmijët e lindur me inseminim artificial nga ana e Edlirës, duke kërkuar njëkohësisht që të njihen dhe regjistrohen me cilësinë “nënë”, në regjistrin përkatës të zyrës së gjendjes civile, ato e kanë të pamundur të kryejnë këtë regjistrim, pasi një kërkesë e tillë është refuzuar me shkresën nr.2627/1 datë 15.04.2021, nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr.2,

Tiranë, me arsyetimin ndër të tjera se, *nuk mund të regjistrohen fëmijë të lindur nga prindër të së njëjtës gjini, pasi kjo gjë nuk është e njohur shprehimisht nga ligji.*

- *Analiza e paraqitur e fakteve dhe provave, nga ana e paditëseve:*
 - Sipas **Konventës për të Drejtat e Fëmijës** (neni 7 dhe neni 54), fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre. Kjo e drejtë, sipas paditëseve, iu mohohet paditëseve të mitura H. dhe A. M., për shkak të mungesës së parashikimeve ligjore për njohjen e familjeve dhe të prindërve të së njëjtës gjini. Kjo pamundësi regjistrimi bie ndesh me Kushtetutën dhe parimin e mbrojtjes së veçantë që duhet të gëzojnë nga shteti fëmijët dhe nënat e reja.
 - Sipas **Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut**, çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare (neni 8), por njëkohësisht edhe Kushtetuta (neni 53) sanksionon se kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje. Në këto rrethana, paditëset A. A. dhe E. M., gjenden në një situatë ku asnjëri prej ligjeve vendase nuk i ofron siguri juridike për mbrojtjen efektive të të drejtave të tyre dhe respektimin e jetës private dhe familjare, të drejtën për të pasur familje. Ato aktualisht “de facto” kanë krijuar familjen e tyre, kanë sjellë në jetë fëmijë, por nuk njihen si të tilla nga ligji.
 - **Ligji nr.10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar**, në nenin 8, parashikon se: “Lindja, gjinia, emri e mbiemri, raportet e atësisë, amësisë dhe shtetësia njihen e mund të hiqen, të shuhën, të ndryshojnë ose t’u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj, apo në çdo ligj tjetër të veçantë”. Megjithatë, ky ligj nuk parashikon se si do të shënohen/njihen përbërësit e gjendjes civile, të paditëseve H. dhe A., nga dy nëna.
 - Pavarësisht përcaktimit të dhënë në nenin 10,¹ të Ligjit nr.10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, dhe megjithëse paditëset A. A. dhe E. M. gjenden para një fakti tashmë të krijuar, pasi kanë konceptuar familjen e tyre, ligji nuk e njeh këtë fakt juridik, pra lindjen e paditësve H. dhe A., nga dy nëna.
 - Megjithëse Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (neni 12), si dhe **Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë** (neni 7 dhe neni 163), e lidhin konceptin e martesës por edhe të bashkëjetesës në mënyrë të drejtëpërdrejtë me bashkim mes një burri dhe një gruaje, **Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut** e ka orientuar çështjen drejt parimit të subsidiaritetit duke sugjeruar një interpretim evolutive të Konventës dhe duke ju referuar legjislacioneve të brendshme të vendeve të Këshillit të Europës, që kanë pranuar në legjislaciononet e tyre të brendshme bashkime të tilla.
 - Edhe pse kërkimi i paditëseve nuk lidhet me të drejtën e tyre për t’u martuar, paditëset A. A. dhe E. M. kanë krijuar “de facto” familjen e tyre dhe kanë lindur fëmijët e tyre, H. dhe A..
 - Mbi këtë bazë kërkohet ndryshimi i aktit administrativ, përkatësisht i shkresës nr.2627/1 datë 15.04.2021, nga ana e Zyrë së Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr.2, Tiranë, dhe detyrimi i kësaj zyre për të regjistruar fëmijët H.

¹ Neni 10, përcakton se: “Fakte juridike të prezumuara me ligj ose të rrjedhura nga veprimet e vetë personit, që vërtetohen, janë raportet e atësisë, amësisë dhe familja”.

- dhe A. M., binjake, të lindura në datën 18.01.2021 dhe për të regjistruar si nëna paditëset A. A. dhe E. M., me të drejta amësie, në të njëjtën përbërje familjare.
- Po kështu, meqenëse legjislacioni në fuqi, i Republikës së Shqipërisë, që rregullon regjistrimin e amësisë nuk rregullon krijimin e marrëdhënieve të amësisë për shkak të vullnetit të përbashkët të nënës biologjike me bashkëjetuesen e saj, i kërkohet gjykatës të vlerësojë shqyrtimin e çështjes nën dritën e nenit 145, të Kushtetutës, pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në *Gjykatën Kushtetuese*.

- **Referimi i legjislacionit në fuqi, konstatime të kryera mbi bazën e kërkesë-padisë, fakteve dhe provave të paraqitura në gjykim:**

- *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, në nenet 53 dhe 54, sanksionojnë se:

Neni 53

1. *Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje.*
2. *Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.*
3. *Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj.*

Neni 54

1. *Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti.*
2. *Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa.*
3. *Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.*

Në këto nene, Kushtetuta njeh dhe afirmon mbrojtjen e veçantë për institutin e martesës (fillimin dhe mbarimin e saj në rast zgjidhjeje të rregulluara me ligj) dhe njëkohësisht të së drejtës që kushdo ka për t'u martuar. Po kështu, Kushtetuta njeh dhe afirmon familjen si një formacion i rëndësishëm social për shoqërinë, duke ritheksuar faktin se edhe familja gëzon mbrojtjen e veçantë të shtetit.

Në vazhdim, Kushtetuta shprehet për garantimin e një mbrojtjeje të veçantë për fëmijët dhe nënat e reja, duke njohur dhe barazuar të drejtat e fëmijëve të lindur jashtë martese me të drejtat e fëmijëve të lindur nga martesa. Qartësisht Kushtetuta nuk shprehet drejtëpërdrejtë në lidhje me ndalimin e martesave të të njëjtit seks, pavarësisht se kuptimi i parë, i përgjithshëm dhe i natyrshëm i gjithkujt mbetet se martesa është lidhja midis një burri edhe një gruaje. Ndërkohë Kushtetuta referon lidhjen dhe zgjidhjen e martesës në Kodin e Familjes, ku edhe bëhen parashikimet ndaluese).

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut,
në nenet 8 dhe nenin 12, parashikon respektivisht se:

Neni 8 - E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. *Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.*
2. *Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike,*

në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.

Neni 12 - E drejta për t'u martuar

Burri dhe gruaja, që kanë mbushur moshën për martesë, kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje, sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte.²

- Konventa për të drejtat e fëmijës,

Neni 1

Në këtë Konventë, me fjalën fëmijë nënkuptohet çdo njeri nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

Neni 3

1. Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore.

2. Shtetet palë angazhohen që t'i sigurojnë fëmijës mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për mirëqenien e tij, duke pasur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tij, të kujdestarëve të tij ligjorë ose të personave të tjerë ligjërisht përgjegjës për të dhe, për këtë qëllim, ato marrin të gjitha masat legjislative dhe administrative përkatëse.

3. Shtetet palë sigurojnë që institucionet, shërbimet dhe qendrat përgjegjëse për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve të veprojnë në përputhje me normat e caktuara nga autoritetet kompetente, veçanërisht në fushën e sigurisë, të shëndetit, të numrit dhe të aftësive të personelit të tyre si dhe të mbikëqyrjes së duhur.

Neni 5

Shtetet palë respektojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ose, sipas rastit, anëtarët e familjes së zgjeruar ose të bashkësisë, siç parashikohet nga zakoni i vendit, kujdestarët ose personat e tjerë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, për t'i siguruar këtij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave të njohura në këtë Konventë.

Neni 7

1. Fëmija regjistrohet menjëherë posa të lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre.

2. Shtetet palë sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe me detyrimet nga instrumentet përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë, sidomos në rastet kur, në mungesë të tyre, fëmija do të mbetej pa shtetësi.

Neni 8

1. Shtetet palë marrin përsipër respektimin e të drejtës së fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, duke përfshirë këtu shtetësinë, emrin dhe lidhjet familjare që njihen me ligj pa ndonjë ndërhyrje të paligjshme.

² Edhe ketu parashikimi ka mundësi të ketë një interpretim evolutiv dhe deri me tash GJEDNJ e ka bërë një gje të tillë duke iu referuar ligjit të brendshëm

2. Në qoftë se një fëmije i mohohen në mënyrë të paligjshme disa ose të gjitha elementet e identitetit të tij, shtetet palë i japin atij ndihmën dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij të rivendoset shpejt.

Neni 21

Birësimi duhet bërë në interesin më të lartë të fëmijëve.

- E drejta Familjare dhe Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë

*Sipas Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (neni 16/3): “**Familja** është njësi themelore dhe natyrore e shoqërisë”. Po sipas këtij traktati ndërkombëtar, në nenin 16/1, përcaktohet se: “**Burri dhe gruaja**, në një moshë të caktuar, pa dallim nga raca, kombësia, besimi, **kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje**”. Pra familja është njësi bazë e shoqërisë, origjina e së cilës nuk lidhet me ekzistencën e shtetit. Ajo është njësi themelore natyrore.*

Edhe modalitetet e reja të konceptimeve mbi jetën familjare e të mosngecjes së saj vetëm me familjen që krijohet nga martesja tregojnë rëndësinë që ka kjo njësi bazë shoqërore. Në kuptimin praktik të saj por edhe në atë teorik familja na shfaqet në kuptimin e ngushtë të saj si dhe në kuptimin e gjerë. Aktualisht nuk ka një përkufizim ligjor përfundimtar për familjen. Kjo është e kuptueshme në procesin e transformimit të shpejtë që pëson shoqëria kohë pas kohe.

*Për këto arsye edhe Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë nuk ka një përkufizim fundor për familjen. Ajo që është e pashmangshme në kuptimin e saj, është se familja është **grupi i personave të lidhur ndërmjet tyre në një lidhje të veçantë. Familja ligjore krijohet mbi bazën e martesës.***

Nga natyra e lidhjes së këtyre personave, dallojmë:

Familjen në kuptimin e ngushtë, që buron prej martesës si një lidhje juridike ndërmjet individëve që cilësohen si “bashkëshortë”, dhe të gjakut (prindër dhe fëmijë). Pra kjo është familja e kompozuar prej bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre.

Familja në kuptimin e gjerë, përfshin veç anëtarëve të familjes së ngushtë edhe persona që lidhen në mënyrë natyrore ose juridike me bashkëshortët, me kushtin që brenda këtij grupimi nuk mund të lidhet martesë.

Familja natyrore ose familja e faktit, në të cilën ekzistojnë lidhjet e gjakut midis prindërve dhe fëmijëve, por kjo familje nuk është krijuar si rrjedhojë e martesës së prindërve.

Familja është një unitet personash ku lidhjet natyrore dhe juridike pleksen me ndjenja e afeksione të veçanta, të cilat nuk ekzistojnë “a priori”, por shfaqen në të drejtat dhe detyrimet që këta komponentë ushtrojnë për shkak të moralit ose të ligjit, në raport me njëri-tjetrin. Familja është njësi sociale dhe juridike. Koncepti i familjes është i lidhur ngushtë me atë të shoqërisë, ndaj edhe shteti merr masa për të krijuar bazën e nevojshme ligjore, sociale dhe ekonomike që familja të mund të arrijë të kryejë plotësisht funksionet e saj (vendosja e lidhjeve emocionale, shoqërore ndërmjet bashkëshortëve dhe të gjithë anëtarëve të familjes; funksioni ekonomik; funksioni i marrëdhënieve seksuale riprodhuese ndërmjet bashkëshortëve në shoqërinë e dhënë; shoqërimi dhe edukimi i fëmijëve dhe i prindërve; funksionet mbrojtëse të kujdesit bazë; shkëmbimi i të mirave dhe i shërbimeve).

Sa i takon **marrëdhëniet familjare** duhet saktësuar fakti se, Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë në përmbajtjen e dispozitave të tij, marrëdhëniet familjare i kupton si marrëdhënie që krijohen nga martesë, birësimi, kujdestaria dhe krushqia.

Kur flasim për **anëtarësi të familjes** është e vështirë të flasim për një anëtarësi të qëndrueshme të familjes. Sikurse është theksuar më lart, sipas përcaktimeve të dhëna në Kodin e Familjes të Republikës së Shqipërisë, familja ligjore krijohet mbi bazën e martesës, ndërkohë që ky kod njeh si burim të jetës familjare edhe bashkëjetesën pa martesë. Sikurse është thënë më lartë, familja është një tërësi personash të lidhur ndërmjet tyre për arsye natyrore ose juridike. Duke patur parasysh faktin se është ligji ai që përcakton sipas situatave të veçanta se, cilët do të jenë anëtarë të familjes (p.sh. Ligji “Për të huajt”, ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, Kodi i Punës, etj), me anëtare të familjes sipas të drejtës familjare të Republikës së Shqipërisë, do të kuptohet gjithë rrethi i personave me lidhje të tillë gjinore ose ligjore, e cila konsiderohet si ndalesë për lidhjen e martesës (familja në kuptimin e gjerë – communi iure). Ndërsa për familjen në kuptimin e ngushtë- proprio iure, familja përbëhet nga bashkëshortët dhe fëmijët e tyre të lindur ose të birësuar.

Koncepti i familjes dhe i **jetës familjare** ka njohur zhvillime të cilat ecin paralel me ndryshimet shoqërore dhe ligjore. (Neni 8 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, nuk përmban një të drejtë për të krijuar jetë familjare, ndërkohë që neni 12 garanton të drejtën për t’u martuar dhe për të pasur familje). Kjo gjë po ndodh ndërkohë që martesë formale, ligjore, po e humbet rëndësinë e saj primare dhe kur po zhvillohet instituti i bashkëjetesës së çifteve, pa martesë. Kjo tregon se familja e bazuar në martesë nuk është e vetmja alternative për të gëzuar jetën familjare. Megjithatë flasim për gëzimin e jetës familjare edhe në rastin e marrëdhëniet midis një nëne dhe fëmijës së saj, pavarësisht nga statusi i saj martesor.³ Gëzojnë jetë familjare çiftet e pamartuara së bashku me fëmijët e tyre. Jeta familjare ekziston edhe në rastet e mungesës së lidhjeve të gjakut.

Në kuptimin e jetës familjare hyjnë: marrëdhëniet midis fëmijëve dhe gjyshërve, lidhjet farefisnore midis emtës dhe ungujt dhe nipit ose mbesës, marrëdhëniet midis prindërve birësues dhe fëmijëve të birësuar.

E drejta për jetë familjare dhe e drejta për të pasur familje. Sipas nenit 53, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kushdo ka të drejtë të ketë familje, aq më shumë fëmijët, të cilët, për të pasur një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, kanë të drejtë të rriten në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi (neni 5, i Kodit të Familjes). Në rast të pamundësisë së ofrimit të jetës familjare nga familja natyrore, kuadri ligjor parashikon “familjen kujdestare”, si një familje alternative, e vendosur nga gjykatat në rastet kur prindërit e fëmijëve janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore. Çështja e jetës familjare është një çështje shumë e brishtë.

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës. Sipas nenit 1, të Konventës për të Drejtat e fëmijës, “...me fëmijë do të kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara⁴”.

Sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, fëmija kur lind i gjallë gëzon zotësi juridike që nga koha e zënies, pra efektivisht për të garantohet në këto kushte mbrojtje juridike.

³ “Marck kundër Belgjikës”, gjykimi i 13 Qershorit 1979.

⁴ Ketu përfshihet rasti i veçante kur me vendim nga ana e gjykatës lejohet lidhja e martesës ndërmjet personave, apo me një person, që ende nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, për arsye të parashikuara në ligj.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk ka një parashikim të veçantë lidhur me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, megjithëse në nenin 54/1 të saj parashikohet se, fëmijët, ashtu sikurse martesë dhe familja, gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti.

Në nenin 2, të Kodit të Familjes, kjo konsideratë parësore e interesit më të lartë të fëmijës është kryesisht detyrë e prindërve, si edhe e organeve kompetente dhe e gjykatave, të cilat në të gjitha vendimet dhe verpimtaritë e tyre duhet të kenë në qendër të vëmendjes, pikërisht këtë interes.

Kodi i Familjes, tërheq vëmendjen në rregullimin e instituteve të ndryshme të parashikuara në të dhe më konkretisht, ai thekson në mënyrë të veçantë parimin e interesit më të lartë të fëmijës, në rastet e zgjidhjes së martesës dhe problemeve që dalin prej saj; në veprime dhe vendime të karakterit pasuror; në rastet e braktisjes, birësimi, kujdestarisë etj. Në fakt vlerësimi i respektimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës paraqet një sfidë që kërkon analizimin e njëhershëm të shumë elementëve dhe faktorëve objektivë dhe subjektivë, që kontribuojnë në këtë interes dhe në vendosjen e një balance mes tyre rast pas rasti.

E drejta (e fëmijës) për t'u rritur në një mjedis familjar. Sipas nenit 5, të Kodit të Familjes, çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi. “Mjedisi familjar” nënkupton, elementët subjektivë e objektivë që e kompozojnë familjen, duke kuptuar këtu anëtarët e familjes jo në kuptimin e ngrushtë të saj por edhe në kuptimin e një familjeje kujdestare (birësimi i fëmijëve të mbetur pa prindër).

Martesa. Është një institut i rëndësishëm i së drejtës familjare, që premisën e realizimit të saj e ka tek gëzimi i së drejtës për t'u martuar nga ana e individit që qëllimom lidhjen në martesë. Kjo e drejtë hyn në kategorinë e të drejtave sociale. Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (nenit 53):

“1. Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje.

2. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.

3. Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj”.

Përemri “Kushdo” në këtë rast, lidhet me ndalimin e diskriminimit në kuadër të së drejtës për t'u lidhur në martesë. Pra nuk duhet kuptuar dhe interpretuar si një e drejtë dhe mundësi e lidhjes në martesë ndërmjet çifteve të të njëjtit seks.

Neni 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, parashikon se: “Burri dhe gruaja, që kanë mbushur moshën për martesë, kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje, sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte”. Pra kjo e drejtë i njihet vetëm një çifti heteroseksual, që dëshiron të martohet dhe të krijojë familje. Por jo vetëm martesë formale mund të krijojë një familje si të tillë.

Thelbi i së drejtës për martesë, sipas këtij kuptimi dhe koncepti të huazuar edhe nga legjislacioni ynë i së drejtës familjare (vecanerisht nga Kodi i Familjes), është formimi i raporteve juridike të detyrueshme midis një burri dhe një gruaje. Edhe në zhvillimin historik të institutit të martesës dhe së drejtës për martesë në vendin tonë, një element i pandryshueshëm ka qënë ai i së drejtës për të lidhur martesë, vetëm ndërmjet një burri dhe një gruaje, pra një çifti heteroseksual, bazuar kjo edhe në traditat, zakonet, mendësinë dhe opinionin e përgjithshëm shoqëror, në konsiderimin parësor të institutit të martesës.

Në nenin 7, të Kodit të Familjes, gjejmë përcaktimin se: “Martesa është një lidhje midis një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç”. Kjo lidhje në mënyrë të

padiskutueshme shoqërohet prej zhvillimit të një jete të përbashkët, ndërmjet burrit dhe gruas të lidhur në martesë.

Nga studimi i Kodit të Familjes në tërësi, arrihet në përcaktimin se martesë është një akt juridik, tipik, solemn, personal, përmes të cilit një burrë dhe një grua, marrin përsipër detyrime reciproke, duke i dhënë martesës në këtë kuptim edhe natyrën e një marrëdhënieje juridike në vazhdim.

Cilat janë parimet e martesës sipas legjislacionit tonë?

Sipas legjislacionit tonë, martesë, si një bashkim vullnetar ndërmjet një burri dhe një gruaje duhet të jetë, një bashkim monogam; një bashkim heteroseksual; një bashkim i lirë dhe vullnetar; një bashkim potencialisht i përjetshëm (pa afat); bashkim ndërmjet personave që kanë arritur një moshë të përcaktuar; një bashkim i realizuar publikisht para nëpunësit përgjegjës shtetëror dhe si një bashkim që mbështetet si bashkësi morale, shpirtërore dhe materiale, që lidhet me pëlqimin e lirë të bashkëshortëve. Diversiteti i sekseve është parashikuar si parim jo vetëm për martesën në legjislacionin tonë në fuqi, por edhe për bashkëjetesën e faktit.

Vlen të ndalemi veçanërisht tek parimi i dytë më sipër, pasi diversiteti i sekseve të bashkëshortëve nuk përmendet në mënyrë të veçantë nga ligji, as si kusht dhe as si ndalesë e veçantë (për lidhjen e martesës), në institutin e martesës. Sikurse kemi theksuar më lart, heteroseksualiteti është një parim i institutit të martesës dhe në këtë kuptim parimet kanë rëndësi pasi shkelja e tyre i humbet kuptimin në thelb institutit të martesës.

Sipas ligjit “Për gjendjen civile”, seksi është një prej përbërësve të gjendjes civile të personit që, ndryshe nga disa përbërës të tjerë si lindja, emri e mbiemri, raportet e atësisë, të amësisë ka disa veçori. Lindja, emri e mbiemri, raportet e atësisë, të amësisë janë përbërës që njihen. Me përjashtim të seksit, të gjithë këta përbërës mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ose t’u kalojnë të tjerëve, sipas parashikimeve të Kodit të Familjes dhe ligjit “Për gjendjen civile”. Ndryshimi i seksit nuk lejohet nga legjislacioni ynë. Jo vetëm kaq por mund të thuhet se, ligjvënësi duke mos parashikuar si pengesë të mundshme ligjore, seksin e njëjtë për lidhjen e martesës, ka injoruar plotësisht ekzistencën dhe mundësinë e lidhjes së këtyre lloj martesave.

Bashkëjetesa e faktit, është një institut i ri i së drejtës familjare në Shqipëri. Bashkëjetesat pa martesë janë rritur dhe tashmë janë një dukuri normale e shoqërisë sonë. Familje kemi edhe atëherë kur çifti bashkëjeton, duke evidentuar kështu një formë të re, të jetës familjare. Në nenin 163, të Kodit të Familjes parashikohet se: “Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie”. Pra edhe këtu, sikurse shihet, kemi të bëjmë me parashikimin për një bashkim heteroseksual dhe monogam.

Amësia dhe atësia e fëmijës (prejardhja). Këto së bashku me emrin, mbiemrin, shtetësinë, kombësinë dhe përbërës të tjerë të gjendjes civile janë të dhëna personale të personit, dhe të drejta jopasurore që mund ti gëzojë vetëm qenia njerëzore që ka lindur gjallë. Duke u përfshirë në identitetin e personit, shërbejnë për të krijuar statusin e tij vetjak, status ky që konsiderohet interes dhe e drejtë themelore e rangut të pare, e sanksionuar si e tillë në Konventën “Për të drejtat e fëmijës”. Atësia dhe amësia janë elementë të rëndësishëm për të përcaktuar edhe origjinën dhe përkatësinë familjare të një personi, përfshi këtu edhe raportet prindërore. Përcaktimi i përkatësisë familjare të personit është i lidhur dhe duhet konsideruar edhe si pjesë përbërëse e së drejtës për një jetë familjare normale. Veç sa ka parashikuar Kushtetuta jonë lidhur me këtë konsiderim, neni 8/1, i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, ka përcaktuar se, “...lidhjet familjare” janë pjesë e identitetit të

fëmijës”. Sipas së drejtës sonë familjare, raportet prindërore janë raportet mëmë-bir/bijë dhe atë-bir/bijë.

Sot vepronë disa parime të përgjithshme, mbi amësinë dhe atësinë e fëmijëve, në trajtimin ligjor të kësaj çështjeje, në të drejtën tonë familjare:

- Parimi i barazisë së fëmijëve të lindur nga martesa dhe të atyre të lindur jashtë saj.
- E drejta e nënës për të kërkuar njohjen ose kundërshtimin e atësisë ose të amësisë, është një e drejtë a pavarur dhe e pakushtëzuar nga e drejta e secilit prind për të kërkuar ato. Sipas këtij parimi, e drejta e fëmijës për të njohur amësinë dhe atësinë e tij konkurron me të drejtën e secilit prind për të kërkuar përkatësinë e tij prindërore ndaj të njëjtit fëmijë. Nisur nga interesi më i lartë i fëmijës, legjislacioni ynë ka parashikuar se e drejta e fëmijës për të kërkuar amësinë dhe atësinë e tij nuk parashkruhet, ndryshe nga e drejta e prindërve të tij, të cilëve kjo e drejtë u parashkruhet me kalimin e një periudhe kohore të caktuar nga ligji.
- Përparësia e vullnetit të lirë të prindërve për njohjen e amësisë dhe të atësisë së fëmijës.

Sipas nenit 165, të Kodit të Familjes, “Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur nga martesa provohet nga akti i lindjes, i regjistruar në regjistrin e gjendjes civile”. Në nenin 34 të ligjit “Për gjendjen civile”, deklarimi i lindjes së fëmijës është veprimi i dytë që kushtëzon përpilimin e aktit të lindjes. Po ky ligj përcakton se si rregull, deklarimi i lindjes së fëmijës bëhet nga njëri ose të dy prindërit e tij, por në ligj është parashikuar që ky deklarim mund të bëhet edhe nga persona të tjerë, të lejuar nga ligji. Lidhur me zyrën kompetente, për të pranuar deklarimin e lindjes së një fëmije, parashikohet se ky deklarim bëhet pranë zyrës së gjendjes civile ku kanë regjistrimin e tyre prindërit e fëmijës, nënkuptuar këtu si prindërit e martuar edhe ata beqarë. Deklarimi i lindjes së fëmijës duhet të bëhet sa më parë (afat maksimal 45 ditë), sepse kështu do të mundësohet sa më shpejt, përpilimi i aktit të lindjes së fëmijës dhe regjistrimi i tij në regjistrat e gjendjes civile.

Në ligjin “Për gjendjen civile”, nuk u është dhënë zgjidhje rasteve kur nëpunësi i gjendjes civile refuzon të pranojë deklarimin, të përpilojë aktin e lindjes së fëmijës ose edhe ta regjistrojë atë.⁵

Konsiderohet fëmijë i lindur jashtë martese, ai fëmijë që është lindur nga një grua e cila në momentin e konceptimit dhe të lindjes nuk rezulton e martuar, në aktet e saj të gjendjes civile. Fëmijë i lindur jashtë martese është edhe ai fëmijë që, ndonëse është lindur nga një grua e martuar ligjërish, atësia e prezumuar e burrit të ligjshëm të nënës është ç’njohur me vendim gjyqësor të formës së prerë, mbi bazën e kundërshtimit të tij. Në këtë grupim futen edhe ata fëmijë që në aktin e lindjes dhe në regjistrin themeltar të shtetasve, janë regjistruar me prindër të panjohur. Në një përkufizim të përmbledhur, sipas të drejtës sonë familjare, do të konsiderohet fëmijë i lindur nga një grua e panjohur, nga një grua që nuk ka qënë e martuar ligjërish asnjëherë, ose kur kanë kaluar më shumë se 300 ditë nga martesa e saj e fundit, ose kur me vendim të formës së prerë i është ç’njohur atësia që ishte përcaktuar nga zbatimi formal i ligjit. Fakti i të qenit fëmijë i lindur jashtë martese nuk gjen pasqyrim në mënyrë të drejtëpërdrejtë në aktet e gjendjes civile të fëmijës, me qëllim që të mos krijohet kushte për diskriminimin e tij.

Sipas nenit 170, të Kodit të Familjes: “Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur jashtë martese mund të vendosen me anë të njohjes vullnetare ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor...”. Përcaktimi i amësisë së fëmijës së lindur jashtë martese është i lidhur me

⁵ Teorikisht subjektet e interesuar mund kundërshtojnë mosveprimin e nëpunësit të gjendjes civile pranë organit më të lartë administrativ përkatës dhe kundër vendimit përfundimtar administrativ mund ti drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

qëndrimin e nënës dhe vullnetin e saj për të përmbushur me saktësi procedurat e nevojshme administrative, të nevojshme për përpilimin e dokumenti bazë të lindjes dhe të aktit të lindjes.

Me përfundimin e përpilimit të aktit të lindjes së një fëmije dhe me regjistrimin e tij në regjistrin themeltar të shtetasve me amësi të panjohur ose kur kalon afati 45 ditor i parashikuar nga ligji “Për gjendjen civile”, për deklarimin e lindjes dhe për regjistrimin e tij, si dhe kur fëmija mbetet i paregjistruar, nënës nuk i humbet e drejta për ta njohur atë fëmijë dhe për ti vendosur atij emrin e vet si amësi. Për të realizuar njohjen e saj si nënë e një fëmije të regjistruar me nënë të panjohur, ose të paregjistruar ende, Kodi i Familjes, në nenet 169, 170, 176 i ka njohur nënës për së gjalli, dy rrugë:

- rrugën administrative nëpërmjet deklarimit vullnetar përpara nëpunësit të gjendjes civile

- nëpërmjet rrugës gjyqësore.

Sipas nenit 181, të Kodi të Familjes: “Atë i fëmijës së lindur jashtë martesë është personi madhor që e njuh si fëmijën e vet”.

Zhvillimet shkencore në fushën e shëndetësisë si inseminimi artificial, nxjerrin nevojën jo vetëm të rregullimit ligjor sa më të detajuar, lidhur me mënyrat e përdorimit të këtyre zbulimeve shkencore në favor të shtetasve, por edhe për mënyrat e përdorimit të tyre si fakte e prova në procesin e përcaktimit ose të vërtetimit të amësisë dhe të atësisë së një fëmije të regjistruar pa amësi e atësi, të atyre të lindur jashtë martesë, si dhe për kundërshtimin e tyre.

Prind bëhesh për shkaqe natyrore ose juridike (birësimi). Për njërën ose tjetrën arsye është ligji ai që të njuh si prind. Jo gjithnjë prindërit biologjikë të fëmijës janë edhe juridikisht prindërit e tij. “Prindi ligjor i fëmijës” përcaktohet si personi ose personat (jo më shumë se dy, të sekseve të kundërta), pra ai/ajo (ata), i cili (e cila) është njohur si i tillë/e tillë në një mënyrë të përcaktuar nga ligji. Në këtë mënyrë për shkak të interesit më të lartë të fëmijës, jo më kot ndodh që marrëdhëniet me prindin, prindëria (qënia prind) dhe **përgjegjësitë prindërore** krijohen ose lindin që në castin e lindjes së fëmijës ose të vendosjes së birësimit dhe me kalimin e kohës këto raporte të krijuara forcohen. Prind bëhesh jo vetëm nga shkak i martesës, por edhe për shkak të martesës. Prind bëhesh vetëm nga pasja e fëmijëve dhe e njohjes së tyre ligjërish si të tillë.

Përgjegjësia prindërore është e lidhur ngushtësisht me institute të tilla si amësia, atësia, birësimi, etj. Sipas nenit 217, të Kodit të Familjes “Fëmija ndodhet nën përgjegjësinë prindërore deri në moshën madhore”. Pra, megjithëse jo e shprehur drejtëpërdrejtë, përgjegjësia prindërore nis me lindjen e fëmijës. Legjislacioni ynë i familjes e ka dimensionuar të drejtën për përgjegjësi prindërore si të drejtë të prindit (prindërve) të fëmijës të njohur ligjërish si të tillë. Kur flasim për përgjegjësinë prindërore dallohen dy momente, së pari, atë se kujt i përket kjo përgjegjësi (kjo pjesë lidhet ngushtë me institutin e amësisë dhe atësisë) dhe së dyti, kush e ushtron përgjegjësinë prindërore. Instituti i përgjegjësisë prindërore është i lidhur ngushtë me amësinë, atësinë dhe birësimin.

Si duhet të kuptohet përkatësia **prindërore në rastin e zbatimit të teknikave të riprodhimit mjekësor të asistuar**, që sjellin paqartësi në lidhje me faktin se cilët janë prindërit biologjikë e aq më shumë, prindërit ligjorë të fëmijës.⁶ Dëshira dhe e drejta për të pasur fëmijë është sa natyrore po aq edhe ligjore. Qëllimi i zbatimit të këtyre teknikave, të riprodhimit mjekësor të asistuar, është që ti përgjigjet kërkesës dhe të drejtës së një

⁶ Ligji nr.8876 datë 4.04.2002 “Për shëndetin riprodhues”, i ndryshuar. Neni 30: “Riprodhimi mjekësor i asistuar ka për qëllim t’i përgjigjet kërkesës së një individi ose të një çifti për të pasur fëmijë. Ai synon të trajtojë një ose disa shfaqje mjekësore të infertilitetit, që bëjnë që një çift të mos arrijë një shtatzëni me rrugë natyrore”.

individit ose të në çifti, i cili nuk arrin shtatzani, për të pasur fëmijë. Sipas rregullimeve të ligjit “Për shëndetin riprodhues”, një nga teknikat e përdorura për insemiminim artificial, është ai që njihet si, **“inseminimi jashtëmartesor”**. Ky rast njihet si i tillë pasi ndodh kur bëhet fjalë për ti dhënë një fëmijë një çifti të palidhur në martesë, ose një gruaje të vetme. Ndërsa praktika botërore njihet edhe raste të këtij inseminimi për çiftet e homoseksualëve, realiteti ynë ligjor nuk e njih dhe nuk bën fjalë për dhënien e një fëmije një çifti homoseksualësh. Kjo pasi martesa dhe bashkëjetesa njohin parimin e heteroseksualitetit. Nëse gruaja e pamartuar e bën këtë trajtim vetëm, dhuruesi i semeneve nuk trajtohet si baba i fëmijës dhe sipas ligjit ky fëmijë quhet “pa baba”. Në fakt nuk ka një rregullim të plotë ligjor në legjislacionin aktual lidhur me këto raste.

- **Ligji nr.10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar.**

Neni 2 - Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

2. “Regjistri Kombëtar” i vitit 2010 (në vijim Regjistri Kombëtar) është dokumenti shtetëror unik, ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj dhe çdo personi pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

4. “Përbërës të gjendjes civile” janë të gjitha elementet e përcaktuara në këtë ligj, që shërbejnë për përcaktimin e identitetit të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj apo çdo personi pa shtetësi me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 6 - Përbërësit dhe veçoritë e gjendjes civile të shtetasve

1. Përbërësit e gjendjes civile janë: emri e mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, vdekja, shpallja i/e zhdukur, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera, të parashikuara me ligj.

2. Shtetësia shqiptare, si përbërës i gjendjes civile, është elementi i vetëm dallues nga shtetasit e 3 huaj dhe personat pa shtetësi.

3. Elementet përbërëse në dokumentet e shërbimit të gjendjes civile kanë përparësi ndaj të njëjtave elemente të çdo akti tjetër, shtetëror ose privat dhe janë të detyrueshme të respektohen.

Neni 7 - Numri personal

1. Numri personal është numri unik i papërsëritshëm, që i caktohet çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj, si dhe çdo personi pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm/të përhershëm, me lidhje të caktuara ekonomike nga shërbimi gjendjes civile.

2. Mënyra e formimit të këtij numri përcaktohet me ligj të veçantë.

Neni 8 - Veçoritë e disa përbërësve të gjendjes civile

Lindja, gjinia, emri e mbiemri, raportet e atësisë, amësisë dhe shtetësia njihen e mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ose t’u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj apo në çdo ligj tjetër të veçantë.

Neni 9 - Përbërës të rrjedhur nga ngjarje natyrore

Lindja, koha e lindjes, gjinia, amësia dhe vdekja vërtetohen rregullisht, si fakte juridike, nga personat dhe organet, të cilëve u njihet ky tagër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10 - Përbërës të prezumuar ose të rrjedhur nga veprimet e vetë personit

Fakte juridike të prezumuara me ligj ose të rrjedhura nga veprimet e vetë personit, që vërtetohen, janë raportet e atësisë, amësisë dhe familja.

Neni 27/1 - Aktet për lindjet, martesat e vdekjet

1. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes plotësohen e pasqyrohen në akte të veçanta, në formë elektronike dhe të printuara vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë ose ka pranuar personalisht deklaratimet për faktin e lindjes, lidhjen e martesës ose vdekjen, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto akte mbahen, për çdo rast, të renditura kronologjikisht.

Neni 38 - Dokumentet bazë të lindjes

1. Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor.
2. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vërtetimi i faktit të lindjes mund të provohet edhe nëpërmjet gjykatës.
3. Dokumentet e mësipërme shërbejnë për plotësimin e aktit të lindjes.

Neni 40 - Deklarimi i lindjes

1. Lindja e fëmijës deklarohet te nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët, dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokurë të posaçme.
2. Deklarimi i lindjes së fëmijës së gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, bëhet nga organet e njësisë së qeverisjes vendore, organi i rendit publik, në juridiksionin e të cilit ndodhet vendi i gjetjes, në bazë të procesverbalit të mbajtur në kohën e gjetjes së fëmijës.

Neni 41 - Regjistrimi i lindjes

1. Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve ose në vendin ku ka ndodhur lindja.
2. Për fëmijën e gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, regjistrimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendit ku është gjetur.
3. Shfuqizuar.
4. Kur regjistrimi i lindjeve kryhet brenda 60 ditëve, për lindjen brenda vendit dhe brenda 90 ditëve, për lindjen jashtë vendit, nëna përfiton shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.
5. Fondi për shpërblimin për regjistrimin e lindjes brenda afatit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4, të këtij neni, përballohet nga Buxheti i Shtetit. Procedurat për përfitimin e shpërblimit përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon shërbimin e gjendjes civile.
6. Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara, që çdo ditë të hënë, të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, njoftimin për lindjet e ndodhura pranë institucioneve të tyre.
7. Njësitë operative të policisë në terren, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, konstatojnë dhe konfirmojnë, në rrugë zyrtare, rastet e lindjeve dhe regjistrimin e tyre nga personat e parashikuar në pikën 2 të nenit 40 të këtij ligji, në zonën që mbulojnë.

Neni 42 - Akti i lindjes

1. Akti i lindjes vërteton ligjërisht lindjen e shtetasit.
2. Akti i lindjes është procesverbali, që mbahet për çdo të lindur, i nënshkruar nga nëpunësi i gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe deklaruesi. Ai përmban:
 - a) numrin rendor, datën e mbajtjes dhe zyrën e gjendjes civile;
 - b) datën e plotë dhe orën e lindjes;
 - c) vendin e lindjes;
 - ç) emrin e mbiemrin, të caktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi;
 - d) numrin personal të fëmijës;
 - dh) gjininë;
 - e) Shfuqizuar.
 - ë) shtetësinë;
 - f) faktin nëse ka lindur normal, binjak apo siamez;
 - g) numrin personal dhe identitetin e nënës;
 - gj) numrin personal dhe identitetin e babait, kur njihet, sipas dispozitave ligjore në fuqi;
 - h) identitetin, numrin personal dhe cilësinë e deklaruesit;
 - i) numrin personal, emrin dhe mbiemrin e përkthyesit.

- ***Ligji nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.***

Neni 3 - Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

....

14. “Prind” është personi që e ka lindur ose e ka birësuar fëmijën, çift ose i vetëm, i martuar ose jo, apo që ka njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.

Neni 5 - Parime të përgjithshme Realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime:

.....

2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën

Neni 6 - Zbatimi i interesit më të lartë të fëmijës

1. Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.

Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

- a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;
- b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar; c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;
- ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t’iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.

Neni 8 - E drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe ruajtur identitetin

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, fëmija ka të drejtë:

a) të regjistrohet falas, menjëherë me lindjen e tij. Këtë të drejtë e kanë edhe fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me kërkesë të prindit ose kujdestarit, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

b) të ketë një emër;

c) të fitojë shtetësinë;

ç) të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesin e prindërve, aq sa është e mundur.

2. Fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme.

3. Në rast se një fëmijë është privuar në mënyrë të paligjshme nga një ose disa elemente të identitetit të tij, atij i sigurohet ndihma e përshtatshme për ta rikthyer në identitet, përfshirë edhe garantimin e përkujdesjes së institucioneve shtetërore, për t'i dhënë mundësinë që të praktikojë fenë, kulturën dhe gjuhën e origjinës. Ndihma mund të përfshijë dhënien e informacionit gjenetik për:

a) gjetjen e prindërve;

b) gjetjen e të afërmeve ose të familjarëve të fëmijës, refugjatë e azilkërkuës, me qëllim bashkimin familjar;

c) regjistrimin e çdo ndryshimi të identitetit të fëmijës, si emri, shtetësia, të drejtat prindërore.

4. Regjistrimi dhe vërtetimi i faktit të lindjes bëhet në përputhje me kriteret, rregullat dhe procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi.

.....

- **Opinion “Amicus Curiae” i Avokatit të Përgjithshëm Kokott, (dorëzuar në 15 Prill 2021), për Çështjen C-490-20 (Gjykata e Strasburgut), Case C-2/21, Rzecnik Praw Obywatelskich (çështje ende në gjykim).**

A duhet që një shtet anëtar i Këshillit të Europës të lëshojë një certifikatë lindjeje ku jepen dy gra si nëna, një prej të cilave është me kombësi të këtij shteti anëtar, për një fëmijë të lindur në një shtet tjetër anëtar, në të cilin ky fëmijë është njohur (regjistruar) me një certifikatë të tillë lindjeje?”

Kazusi: Ligji spanjoll lejon martesë midis personave të të njëjtit seks. Dy gra, njëra me kombësi Bullgare dhe tjetra me kombësi Britanike, kanë qëndruar me banim në Spanjë dhe janë martuar bashkë, në vitin 2018. Në vitin 2019, ato u bënë me një vajzë e cila lindi në Spanjë dhe e cila jeton atje, së bashku me dy prindët e saj. Certifikata e lindjes e lëshuar për vajzen e këtij çifti të lidhur në martesë, nga ana e shteti spanjoll, përcakton aplikantin në procedurën kryesore si “Nëna A” dhe bashkëshorten e saj si “Nëna” e fëmijës. Në vitin 2020, aplikanti i procedurës kryesore të regjistrimit të lindjes, aplikoi në Sofie, Bullgari, për pajisjen me certifikatë lindjeje të vajzës së saj, si një dokument i nevojshëm sipas ligjit bullgar për lëshimin e një dokumenti identiteti bullgar për vajzën. Për këtë qëllim aplikantja paraqiti një ekstrakt të certifikuar dhe legalizuar në gjuhën bullgare, të regjistrit të statusit civil të Barcelonës, lidhur me certifikatën e lindjes së fëmijës. Bashkia e Sofies, e instrukttoi aplikantin që të paraqiste brenda 7 ditëve, evidencën e prejardhjes

së fëmijës sa i takon nënës së saj biologjike. Kjo pasi legjislacioni bullgar parashikonte rubrikat vetëm për nënën dhe babain e fëmijës dhe në këto kushte, vetëm një emër nënë mund të futej në këtë rubrikë. Aplikanti kryesor iu përgjigj bashkisë se ajo nuk mund të plotësonte këtë kërkesë dhe se, sipas ligjit bullgar asaj nuk i kërkohej që të bënte këtë gjë. Në vazhdim, Bashkia e Sofies e refuzoi këtë aplikim, me vendim, me arsyetimin se mungonte informacioni lidhur me nënën biologjike të fëmijës dhe faktin se, regjistrimi i dy prindërve femra në një certifikatë lindjeje, ishte në kundërshtim me politikat publike të Bullgarisë, ku nuk lejohet martesat ndërmjet dy personave të të njëjtit seks. Aplikanti kryesor e ankmoi çështjen në Gjykatën Administrative të Sofies.

Gjykata vendosi se, mosnxjerrja e një dokumenti të tillë nuk përbën refuzim për gëzimin e kombësisë bullgare sipas legjislacionit bullgar në fuqi. Gjykata ka arsyetuar ndër të tjera se, parashikimet ligjore që rregullojnë prejardhjen e fëmijës janë të një rëndësie thelbësore në traditën konstitucionale bullgare dhe në literaturën legale bullgare mbi familjen dhe të drejtën e trashëgimisë, të dyja nga një perspektivë e pastër ligjore dhe nga pikëpamja e vlerave, duke pasur parasysh fazën aktuale të zhvillimit të shoqërisë në Bullgari.

Pra, gjykata ka ngritur çështjen nëse është e nevojshme të vendoset një balance ndërmjet interesave të ndryshëm, të ligjshëm, të përfshirë në këtë çështje: nga njëra anë, identiteti kombëtar i Republikës së Bullgarisë dhe nga ana tjetër, interesat e fëmijës dhe në veçanti, e drejta për privatësi dhe lëvizje të lirë meqë fëmija nuk ka asnjë përgjegjësi për diferencat në shkallët e vlerave në shoqëri ndërmjet vendeve anëtare të BE. Më specifikisht, dëshiron të dijë nëse një balancë e pranueshme ndërmjet këtyre interesave të ndryshëm legjitim mund të arrihet nëse, regjistrohet vetëm një nga nënat e dhëna në certifikatën e lindjes spanjolle dhe nëse rubrika e “babait”, qëndron e bardhë.

Çfarë duhet bërë që kërkesa për regjistrimin e të dy nënave të bëhet e detyrueshme duke patur parasysh se gjykata bullgare është e pazonja që të zëvendësojë modelin e certifikatës së lindjes që është fuqi.

Shteti Bullgar ka refuzuar të lëshojë një certifikatë të tillë, pasi legjislacioni bullgar nuk lejon regjistrimin e dy nënave si prindër të një fëmije në një certifikatë lindjeje, ndërkohë që, shteti spanjoll ka vepruar ndryshe.

Kjo është një çështje shumë sensitive në fushën e kombësisë dhe së drejtës familjare dhe për diferencat e mëdha që ekzistojnë brenda BE-së, sa i takon statusit ligjor dhe të drejtave që u janë dhënë çifteve të të njëjtit seks.

Neni 46/1, i Kushtetutës Bullgare e parashikon martesën si, “një bashkim vullnetar mes një burri dhe një gruaje”. Ligji bullgar nuk lejon as martesë apo ndonjë formë tjetër bashkimi me efekte ligjore ndërmjet personave të të njëjtit seks.

Prejardhja rregullohet nga Kodi i Familjes (bullgar), në nenin 60/1/2, ku thuhet se;

- Prejardhja në respekt të amësisë përcaktohet nga lindja.
- Nëna e fëmijës është gruaja e cila ka lindur fëmijën, përfshirë rastin e riprodhimit të asistuar.

Neni 61, i Kodit të Familjes (bullgar), parashikon se:

- Bashkëshorti i nënës konsiderohet të jetë babai i fëmijës së lindur gjatë martesës ose brenda 300 ditëve nga zgjidhja e saj.
- Nëse fëmija ka lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës por më pas nëna është rimartuar, bashkëshorti në martesën e re do të konsiderohet të jetë babai i fëmijës.

Në përputhje me nenin 64, të Kodit të Familjes, ku prejardhja (atësi dhe amësi) e fëmijës për njërin prej prindërve të tij është e panjohur, çdo prind mund të njohë fëmijën e tij ose të saj. Kjo njohje bëhet, në përputhje me nenin 65 të këtij kodi, me anë të deklaratave të njëanshme në një zyrë të gjendjes civile apo një deklaratë të firmosur dhe të certifikuar nga një noter.

Kur marrëdhënia prind-fëmijë, sa i takon një prindi (nënës ose babait) nuk është vendosur, kur hartohet një certifikatë lindjeje në Republikën e Bullgarisë, fusha korresponduese për të dhënat që lidhen me këtë prind nuk do të plotësohet dhe do të vendoset me kryq.

Nëse Kushtetuta e vendit parashikon se, një person është shqiptar nëse së paku njëri prej prindërve është një shtetas bullgar, atëherë gëzimi i shtetësisë shqiptare është automatik dhe për rrjedhojë nuk ka nevojë për nxjerrjen e një akti administrativ për dhënien e shtetësisë fëmijës.

Nëse Bullgaria është e lirë të përcaktojë prejardhjen në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, kjo domosdoshmërisht do të thotë se do të mund të konsiderohet vetëm një grua si nëna e fëmijës, qoftë nëna biologjike, apo gruaja e cila ka pranuar fëmijën.

Një nga të drejtat e njohura për shtetasit e vendeve anëtare të BE-së është e drejta për të pasur një jetë normale familjare, së bashku me anëtarët e tyre të familjes, si në vendin pritës anëtar i BE-së, ashtu edhe në vendin anëtar të BE në të cilin ata janë shtetas, kur ata kthehen në këtë vend.

Gjykata e Strasburgut ka pasur rastin që të specifikojë në këtë kontekst se, “anëtarët e familjes”, janë në çdo rast ata të përmendur në nenin 2(2) të Direktivës 2004/38.⁷ Ky përcaktim i referohet inter alia “bashkëshortes” së një shtetasi të BE (neni 2 (2) (a)) dhe “pasardhësve direkt”, të tij/saj (neni 2 (2) (c)). Nëse bashkëshortja e të njëjtit seks të një shtetasi të BE me të cilën ky shtetas ka lidhur një martesë të vlefshme, sipas legjislacionit të një vendi anëtar, nuk është klasifikuar si një “anëtar familje”, mbi bazën që ligji i një shteti tjetër anëtar nuk parashikon këtë mundësi, kjo gjë mund të rrezikonte një ndryshim në të drejtat që rrjedhin nga neni 21(1)I TFEU nga njëri shtet anëtar tek tjetri, në varësi të parashikimeve të legjislacionit të tyre të brendshëm.

Dështimi për të njohur këto marrëdhënie familjare të vendosura në Spanjë mund të krijojë pengesa serioze për jetën familjare të një familjeje në Bullgari.

Në përputhje me Nenin 4(2) Tractat of European Union, BE-ja duhet të respektojë identitetet kombëtare të qënësishme në strukturat themelore politike dhe konstitucionale të vendeve anëtare. Sidoqoftë, përmbajtja e saktë e këtij koncepti ka gjasa të ndryshojë nga njëri vend anëtar të një tjetër, por natyra e tij e vërtetë, nuk mund të përcaktohet pa

⁷ Në nenin 2/2 të direktivës thuhet se: “Për qëllime të kësaj direktive;

2. Anëtarët e familjes janë:

- a) Bashkëshortja
- b) Partneri me të cilin shtetasi i Unionit ka lidhur një partneritet të regjistruar, mbi bazën e legjislacionit të një vendi anëtar, nëse legjislacioni i vendit anëtar mikpritës i trajton partneritet e regjistruara si ekuivalente me martesën dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin përkatës të vendit anëtar mikpritës.
- c) Pasardhësit direkt të cilët janë nën moshën 21 vjeç apo janë nën përkuqdesje dhe ata të bashkëshortes apo partnerit siç përcaktohet në pikën (b),
- d) Të afërm të drejtëpërdrejtë të varur në linjën zbritëse dhe ato të bashkëshortes apo partnerit siç përcaktohet në pikën (b)”.

marrë në konsideratë konceptet e vendeve anëtare për identitetet e tyre kombëtare. Në këtë kuptim, detyrimi i BE-së për të respektuar identitetet kombëtare të Vendeve Anëtare mund të kuptohet si një detyrim për të respektuar pluralitetin e pikëpamjeve dhe, po kështu, diferencat të cilta karakterizojnë çdo vend anëtar. Identiteti kombëtar garanton kështu moton e BE-së, siç edhe nënvizohet për herë të parë në nenin 1-8, të draft Traktatit që përcakton një Kushtetutë për Europën (Traktati Kushtetues), fjalë për fjalë “Të bashkuar në diversitet”.

Aktualisht nuk ka konsensus brenda Bashkimit Europian mbi parakushtet për akses në institucionet themelore të së drejtës së familjes. Ligjet kombëtare që rregullojnë martesën (apo divorcin) dhe prejardhjen (apo edhe riprodhimin) përcaktojnë marrëdhëniet familjare që qëndrojnë në zemër të kësaj fushe.

Në rast të divorcit, për shembull, janë konstatuar diferenca të pakapërcyeshme gjatë draftimit të një rregulloreje mbi ligjin e aplikueshëm për këtë institut, duke çuar kështu në dështimin e inisiativës legislative të Komisionit, dhe implementimin e bashkëpunimit të zgjeruar në vend të saj.

Sa i takon martesës, vetëm 13 nga 27 vendet anëtare të BE-së, kanë tashmë, zgjeruar këtë institut për çiftet e të njëjtit seks. Për më tepër, prej këtyre 13 shteteve anëtare, vetëm disa ofrojnë prindërimin “automatik”, të gruas së nënës biologjike të një fëmije.

E drejta familjare është një fushë sensitive ligjore që karakterizohet nga një pluralitet konceptesh dhe vlerash në nivel të shteteve anëtare dhe të shoqërive brenda tyre. E drejta familjare - qoftë e bazuar në vlerat tradicionale apo më shumë në vlerat “moderne” - është shprehja e imazhit të shtetit në të dyja nivelet politike dhe sociale. Mund të bazohet në ide religjioze, apo të shënojë heqjen dorë nga këto ide nga shteti në fjalë. Për këtë qëllim, sidoqoftë, në çdo rast është një shprehje e identitetit kombëtar të jetësuar në strukturat themelore politike dhe konstitucionale.

Për më tepër, rregullat që përcaktojnë marrëdhëniet familjare janë të rëndësishme shumë të madhe për funksionimin e komunitetit shtetëror në përgjithësi. Kështu që, kur një shtet aplikon principin e “ius sanguinis”, në këtë kuptim, prejardhja e një personi përcakton kombësinë (shtetësinë) dhe kështu vetë faktin se, një person i përket një shteti të caktuar. Përkufizimi ligjor se çfarë është një familje, apo një prej anëtarëve të saj, ndikon kështu strukturën themelore të shoqërisë. Ky përkufizim ka kështu aftësinë të përfshihet brenda fushës së identitetit kombëtar (shtetëror) të një vendi anëtar brenda kuptimit të Nenit 4 (2) të Traktatit of European Union.

Përcaktimi i prejardhjes për qëllime të së drejtës familjare përfshihet brenda kompetencës ekskluzive të Vendeve Anëtare.

Në këtë konsiderim duhet shënuar në fillim se, koncepti i “jetës familjare”, brenda kuptimit të nenit 7, të Kartës, është në përputhje me përkufizimin e zhvilluar nga Gjykata e Strasburgut, në jurisprudencën e saj mbi Nenin 8 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, nënshkruar në Romë në 4 Nëntor 1950, varur nga ekzistenca reale në praktikë e lidhjeve të afërta personale. Gjykata e Drejtësisë është shprehur se Neni 7, i Kartës, përfshin marrëdhëniet familjare që janë zhvilluar në kontekstin e një marrëdhënieje mes personave të të njëjtit seks, pavarësisht klasifikimit të tyre ligjor në një shtet të caktuar anëtar. Po kështu është e dukshme nga një kombinim i leximit të nenit 24(2) dhe (3) të Kartës se, interesi më i lartë e fëmijës detyron, si një rregull i përgjithshëm, mbajtjen e familjes së bashkuar.

Lidhur me rastin në fjalë duhet konkluduar se Republika e Bullgarisë nuk mund të refuzojë aplikantin dhe bashkëshorten e tij si prindërit e fëmijës për qëllimin e vetëm të aplikimit të së drejtës sekondare të BE-së, për lëvizjen e lirë të shtetasve mbi bazën se, ligji Bullgar nuk parashikon institutin e martesës mes personave të të njëjtit seks apo për amësinë e bashkëshortes së nënës biologjike të një fëmije. (pjesa/njohja e prejardhjes për qëllime të ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga legjislacioni shtetësor i BE-së, për lëvizjen e lirë të qytetarëve, pika 108).

Duke ndaluar martesën ndërmjet personave të të njëjtit seks dhe duke lejuar vetëm njërën grua të jetë nëna e një fëmije në mënyrë të pamohueshme sjell një diferencë në trajtimin ndërmjet çifteve heteroseksuale dhe çifteve homoseksuale. Sidoqoftë, sa i takon martesës, duhet shënuar se aktualisht nuk ka konsensus brenda BE-së se kjo diferencë në trajtim nuk mund të justifikohet. Kështu, Gjykata ka gjetur, deri më sot, në jurisprudencën e saj se, vendeve anëtare nuk iu kërkohet të parashikojnë dhe rregullojnë me ligj institutin e martesës mes personave të të njëjtit seks në legjislacionin e tyre të brendshëm.

Duhet theksuar gjithashtu se Gjykata e Strasburgut është shprehur, deri më tani, se një shteti kontraktues, nuk i kërkohet të autorizojë adoptimin e thjeshtë të një fëmije nga partneri i të njëjtit seks i nënës biologjike të fëmijës.

E drejta për respektimin e marrëdhënieve familjare karakterizohet, në esencë, nga mundësia e jetesës së përbashkët në kushte gjerësisht të krahasueshme me ato të familjeve të tjera. Me fjalë të tjera, ajo që është e rëndësishme me qëllim që të respektohet esenca e kësaj të drejte është që të garantohet një jetë efektive familjare.

Siç thuhet më sipër, edhe nëse marrëdhëniet familjare nuk njihen për qëllime të së drejtës së brendshme familjare, në praktikë jepet siguria se aplikanti në procedurën kryesore dhe bashkëshortja e tij do të jenë në gjendje të jetojnë së bashku me vajzën e tyre në Bullgari dhe në vendet e tjera anëtare të BE-së, në kushte të cilat janë të krahasueshme me ato të familjeve të tjera, pasi në çdo rast ato duhet të trajtohen si anëtare familjeje për qëllime të aplikimit në veçanti të Direktivës 2004/38 dhe Rregullores no. 492/2011.

Mbështetja e Bullgarisë tek identiteti kombëtar (shtetëror) sa i takon përcaktimit të prejardhjes për qëllime të zbatimit në veçanti të së drejtës familjare dhe trashëgimisë bullgare, nuk shkel nenin 2, të Tractat of European Union. Kështu që mund të caktojë, në rastin në fjalë, kufirin e veprimt integrativ të BE-së në këtë kuptim, duke nënkuptuar se Republika e Bullgarisë nuk është e detyruar, sipas nenit 21 (1) të Tractat of European Union, të njohë marrëdhënien prind-fëmijë për qëllime të së drejtës familjare, meqë kjo marrëdhënie është vendosur në Spanjë.

Mbështetja në identitetin shtetëror brenda kuptimit të Nenit 4(2), të Tractat of European Union, mund të justifikojë refuzimin për të njohur që, një çift prej dy grash të jenë prindërit e një fëmije, siç është vendosur në certifikatën e lindjes të lëshuar nga vendi anëtar i vendbanimit, me qëllim të hartimit të një certifikate lindjeje në vendin anëtar të origjinës së fëmijës, apo vendit anëtar të origjinës të një prej këtyre dy grave, duke përcaktuar prejardhjen e këtij fëmije për qëllime të së drejtës familjare të këtij vendi anëtar.

- ***Lidhur me bazueshmërinë dhe përmbajtjen e padisë së paraqitur nga paditëset, A. A., E. M., H. M. dhe A. M.:***

Në objektin e kërkesë padisë së sipërcituar, paditëset, A. A., E. M., H. M. dhe A. M., i kanë kërkuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë:

“Ndryshimin e aktit administrativ, shkresë kthim përgjigje nr.2627/1 datë 15.04.2021 dhe detyrimin e të paditurit për të regjistruar fëmijët H. dhe A. M., binjake të seksit femër, të lindura në 18.01.2021 në Tiranë, dhe për të regjistruar si nëna, paditëset A. A. dhe E. M. me të drejta të barabarta amësie në të njëjtën përbërje familjare”.

Nisur nga objekti i kërimit, konstatohet se:

1. Shkresa nr.2627/1 datë 15.04.2021, “Kthim përgjigje”, e Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr.2, Tiranë, është një akt administrativ, individual.

Për të qenë të saktë në përcaktimin e përkatësisë së kësaj shkrese zyrtare të përpiluar nga ana e zyrës së gjendjes civile të cituar më sipër, duhet të referohemi në përcaktimet e dhëna në ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Më konkretisht në nenin 3, pika 1, gërma “a”, të këtij kodi thuhet shprehimisht se: “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”.

Ndërkohë, në nenin 90, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet shprehimisht se: “1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, përfundon me një vendimmarrje përfundimtare për çështjen, përkatësisht një akt administrativ apo një kontratë administrative. Në vendimin përfundimtar për çështjen, organi publik vendos për të gjitha çështjet e ngritura nga palët gjatë procedurës dhe që nuk kanë marrë zgjidhje gjatë tij.

2. Përfundimi i procedurës administrative, të nisur kryesisht, është në diskrecion të organit publik, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji.

3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Efektivisht në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një akt administrativ përfundimtar për zgjidhjen e kërkesës së paraqitur nga ana e e shtetaseve A. A. dhe E. M.. Në zbatim të situatës së krijuar nga objekti i kërkesës së paraqitur nga ana e shtetaseve A. A. dhe E. M., në Zyrën e Gjendjes Civile, të Njesisë Administrative nr.2, Tiranë, na vjen në ndihmë parashikimi i kryer në nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative ku thuhet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Pamundësia e arritjes së objektit të përcaktuar në kërkesë dhe për të cilin ka nisur paraprakisht procedura nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile, të Njesisë Administrative nr.2, Tiranë, si dhe pamundësia e qëllimit të shprehur nga ana e kërkuueseve për t’u arritur përmes procedurës administrative të vënë në lëvizje, para zyrës së sipërcituar të gjendjes civile, vijnë kryekëput nga legjislacioni i familjes, në fuqi, në Republikën e Shqipërisë.

Analiza e drejtëpërdrejtë që bëhet në këtë rast është nëse, kemi të bëjmë me të drejta ekzistuese të paditëseve të cilat janë mohuar apo shkelur nga ana e organit përkatës të administratës publike, apo këto të drejta nuk ekzistojnë në kontekstin e parashtruar prej paditësve, qoftë gjatë procedurës administrative, apo qoftë edhe në kërkesë padinë që ka vënë në lëvizje gjykimin, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë!

Objekti ose qëllimi i procedurës është bërë i pamundur kur kryerja e një veprimi administrativ ka humbur aktualitetin e tij për shkak të rrethanave që mund të jenë faktike, ose ligjore. Në fakt dhe në thelb, rrethanat ligjore nuk e parashikojnë dhe as nuk e mundësojnë kryerjen e veprimit administrativ, ashtu sikurse është kërkuar nga ana e kërkueseve, përkatësisht shtetaseve A. A. dhe E. M..

Megjithatë kjo situatë e prezantuar ka një rrugëdalje, pasi ligji mundëson kryerjen e veprimit administrativ për regjistrimin në regjistrin e gjendjes civile, të fëmijëve të sapolindur, përkatësisht H. dhe A. M., me njohjen dhe regjistrimin e nënës së tyre biologjike dhe me mosdeklarimin e atësisë së tyre.

- Sikurse është analizuar që në fillim të këtij opinioni, paditëset A. A. dhe E. M., në pretendimet e tyre kanë pranuar se megjithëse kanë rreth 10 vite në një bashkim fakti dhe se kanë 7 vite që bashkëjetojnë përsëri janë të ndërgjegjshme se, legjislacioni i familjes në Shqipëri nuk njeh të drejtën për martesë apo bashkëjetesë, mes personave të së njëjtës gjini.

Pa paragjykuar aspak të drejtën e paditëseve për të ndërtuar një jetesë të përbashkët, sikurse kemi analizuar më sipër, Kodi i Familjes si dhe legjislacioni i familjes në tërësi në Republikën e Shqipërisë, nuk njeh të drejtën e martesës ndërmjet dy personave të të njëjtit seks, apo edhe bashkëjetesën faktike që mund të ndodhë ndërmjet tyre. Madje mund të thuhet se, mosparashikimi në ligj, qoftë edhe si pengesë e mundshme për lidhjen e martesës apo njohjen e bashkëjetesës në këto kushte mund të konsiderohet si një mungesë e plotë e mundësisë ligjore që legjitimon sadopak një eveniment të tillë jetësor mes dy personave të së njëjtës gjini. Ligjvënësi duke mos parashikuar si pengesë të mundshme ligjore, seksin e njëjtë për lidhjen e martesës, ka injoruar plotësisht ekzistencën dhe mundësinë e lidhjes së këtyre lloj martesave.

Kjo lloj bashkëjetese faktike e konsideruar si e tillë prej paditëseve, por jo nga ligji, ka shërbyer sipas konceptit të paditëseve për të krijuar një familje dhe jetë familjare të caktuar, ndërmjet tyre. Legjislacioni i familjes në fuqi parashikon dhe rregullon vetëm të drejtat e individëve dhe pasojat që vijnë nga një bashkim heteroseksual dhe monogam ndërmjet tyre, qoftë ky në formën ligjore të martesës, apo edhe të bashkëjetesës faktike të njohur në kushtet e parashikuara në ligj. Njohja e bashkëjetesës nga legjislacioni i familjes, si një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, plotësohet nga ligji edhe me disa kushte të tjera, por gjithmonë duke cilësuar heteroseksualitetin në lidhje.

Paditëset kanë paralelizuar kuptimin e një marrëdhënieje fakti, në këto kushte, të pa njohur nga legjislacioni i familjes, duke i dhënë kësaj marrëdhënieje të gjitha atributet e një bashkëjetese fakti të njohur nga ligji, për të kërkuar dhe pretenduar të drejtat dhe legjitimuar pasojat që ligji parashikon në këto raste. Kur flasim për ligjin, në ligjëratë të drejtë kemi parasysh legjislacionin familjar të brendshëm, të Republikës së Shqipërisë.

Sipas këtij koncepti të përdorur nga paditëset, tashmë marrëdhënia e tyre ka krijuar një familje dhe një jetë familjare.

Në analizën e kryer kemi theksuar se, megjithëse nuk kemi një përkufizim të dhënë për familjen, sot në legjislacionin tonë kemi këto kuptime të saj:

Familjen në kuptimin e ngushtë, që buron prej martesës si një lidhje juridike ndërmjet individëve që cilësohen si “bashkëshortë”, dhe të gjakut (prindër dhe fëmijë). Pra kjo është familja e formuar prej bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre.

Familja në kuptimin e gjerë, përfshin veç anëtarëve të familjes së ngushtë edhe persona që lidhen në mënyrë natyrore ose juridike me bashkëshortët, me kushtin që brenda këtij grupimi nuk mund të lidhet martesë.

Familja natyrore ose familja e faktit, në të cilën ekzistojnë lidhjet e gjakut midis prindërve dhe fëmijëve, por kjo familje nuk është krijuar si rrjedhojë e martesës së prindërve.

Dhe në fakt, lidhur me kuptimin e marrëdhënieve familjare kemi saktësuar faktin se, Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë në përmbajtjen e dispozitave të tij, marrëdhëniet familjare i kupton si marrëdhënie që krijohen nga martesa, birësimi, kujdestaria dhe krushqia.

*Çështja e jetës familjare është një çështje shumë e brishtë, pasi sikurse parashikohet edhe në Kushtetutë kushdo ka të drejtën të ketë familje. Megjithatë diskutimi që shtrohet në këtë rast lidhet me **ndarjen e konceptit të së drejtës ligjore për të krijuar një familje dhe të së drejtës për të qënë pjesë e një familjeje.***

Të dyja paditëset, përkatësisht shtetaset A. A. dhe E. M., para periudhës së bashkëjetesës (apo mbase edhe gjatë kësaj periudhe), kanë qene anëtare të familjeve të tjera, në kuptimin e ngushtë apo të gjerë të tyre, nga të cilat ato kanë prejardhjen dhe me të cilat ato kanë krijuar një marrëdhënie familjare në vazhdimësi. Duke pasur këtë qasje sa faktike aq edhe ligjore, mekanizimi ligjor që ka funksionuar për krijimin, ruajtjen dhe vazhdimin e marrëdhënies familjare në familjet respektive nga të cilat kanë prejardhjen paditëset, nuk funksionon automatikisht për krijimin e një familjeje në kuptimin e ngushtë ndërmjet shtetaseve A. A. dhe E. M., dhe aq më tepër për ruajtjen dhe vazhdimin e një marrëdhënieje familjare të ngushtë ndërmjet tyre, sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni ynë.

- *Paditëset kanë argumentuar ne padi se gjatë bashkëjetesës faktike, zgjerimi i familjes nga ana e tyre është dëshiruar dhe realizuar me ardhjen në jetë të 2 fëmijëve binjakë, vajza, në datë 18.01.2021, nga shtatëzania e zhvilluar nga ana e shtetases E. M., përmes metodave të inseminimit artificial.*

Duke konsideruar të mirëqënë krijimin e një familjeje, nga një bashkim faktik në kushtet e analizuara më sipër, shtetaset A. A. dhe E. M., kanë dëshiruar ardhjen në jetë të fëmijëve, anëtarë të “familjes së tyre në kuptimin e ngushtë”. E thënë ndryshe, dhe në kuptim të legjislacionit të familjes, paditëset kanë dashur të jenë prindër të këtyre fëmijëve dhe të fitojnë edhe përgjegjësi prindërore ndaj tyre.

Sikurse kemi sqaruar me siper: në se praktika botërore njeh edhe raste të inseminimit për çiftet e homoseksualëve, realiteti ynë ligjor nuk e njeh dhe nuk bën fjalë për dhënien e një fëmije një çifti homoseksualësh, pasi martesa dhe bashkëjetesa njohin parimin e heteroseksualitetit. Po sic permendem, per ceshtjet e inseminimit tek çiftet e të njëjtit seks, nuk ka një rregullim ligjor në legjislacionin aktual, ndaj rrjedhimisht nuk mund të thuhet se ky lloj inseminimi u njihet si një e drejtë çiftëve të të njëjtit seks.

Po të shihet me kujdes, në rastin e inseminimit jashtëmartesor, si një teknikë e përdorur në këtë rast nga ana e shtetases E. M., do të mjaftonte vetëm pëlqimi i dhënë nga ana e kësaj shtetaseje për të kryer këtë teknikë.⁸ Kjo sepse edhe vet ligji në përcaktimet e tij përdor terminologji të tilla si “individ”, “bashkëshortë”, duke mos lënë vend për trajtimin e një kërkesë të tillë nga një çift i të njëjtit seks.

⁸ Në gërmën “c”, të nenit 32, të ligjit nr.8876 datë 4.04.2002 “Për shëndetin riprodhues”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Zbatimi i teknikave të riprodhimit kryhet: ç) vetëm pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim për çdo cikël nga **individët** e interesuar”.

- Sikurse thuhet në kërkesë-padi, megjithëse, paditëset A. A. dhe E. M., kanë shprehur vullnetin e tyre për të regjistruar fëmijët e lindur me inseminim artificial nga ana e Edlirës, duke kërkuar njëkohësisht që të njihen dhe regjistrohen me cilësinë “nënë”, në regjistrin përkatës të zyrës së gjendjes civile, ato e kanë të pamundur të kryejnë këtë regjistrim, pasi një kërkesë e tillë është refuzuar me shkresën nr.2627/1 datë 15.04.2021, nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr.2, Tiranë, me arsyetimin ndër të tjera se, nuk mund të regjistrohen fëmijë të lindur nga prindër të së njëjtës gjini, pasi kjo gjë nuk është e njohur shprehimisht nga ligji.

Duke kërkuar një gjë të tillë, para punonjësit të Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr.2, Tiranë, përtej veprimit teknik të regjistrimit të fëmijës, si një detyrim që i lind nga ligji prindit/prindërve të tij, paditëset kanë dashur të legjitimojnë të dhëna që lidhen me origjinën e fëmijëve dhe përkatësinë familjare të tyre, përfshirë këtu edhe raportet prindërore.

Legjislacioni ynë i familjes njih vetëm atësinë dhe amësinë si elementë bazikë të prejardhjes së fëmijës. Këto së bashku me emrin, mbiemrin, shtetësinë, kombësinë dhe përbërës të tjerë të gjendjes civile janë të dhëna personale të personit, dhe të drejta jopasurore që mund ti gëzojë vetëm qenia njerëzore që ka lindur gjallë. Duke u përfshirë në identitetin e personit shërbejnë për të krijuar statusin e tij vetjak, status ky që konsiderohet interes dhe e drejtë themelore e rangut të parë, e sanksionuar si e tillë në Konventën “Për të drejtat e fëmijës”.

Atësia dhe amësia janë elementë të rëndësishëm për të përcaktuar edhe origjinën dhe përkatësinë familjare të një personi, përfshi këtu edhe raportet prindërore. Përcaktimi i përkatësisë familjare të personit është i lidhur dhe duhet konsideruar edhe si pjesë përbërëse e së drejtës për një jetë familjare normale.

Veç sa ka parashikuar Kushtetuta jonë lidhur me këtë konsiderim, neni 8/1, i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, ka përcaktuar se, “...lidhjet familjare” janë pjesë e identitetit të fëmijës”. Sipas së drejtës sonë familjare, raportet prindërore janë raportet mëmë-bir/bijë dhe atë-bir/bijë.

Konsiderohet **fëmijë i lindur jashtë martese** ai fëmijë që është lindur nga një grua e cila në momentin e konceptimit dhe të lindjes nuk rezulton e martuar, në aktet e saj të gjendjes civile. Fëmijë i lindur jashtë martese është edhe ai fëmijë që, ndonëse është lindur nga një grua e martuar ligjërisht, atësia e prezumuar e burrit të ligjshëm të nënës është ç’njohur me vendim gjyqësor të formës së prerë, mbi bazën e kundërshimit të tij. Në këtë grupim futen edhe ata fëmijë që në aktin e lindjes dhe në regjistrin themeltar të shtetasve, janë regjistruar me prindër të panjohur. Në një përkufizim të përmbledhur, sipas të drejtës sonë familjare, do të konsiderohet fëmijë i lindur nga një grua e panjohur, nga një grua që nuk ka qënë e martuar ligjërisht asnjëherë, ose kur kanë kaluar më shumë se 300 ditë nga martesa e saj e fundit, ose kur me vendim të formës së prerë i është ç’njohur atësia që i ishte përcaktuar nga zbatimi formal i ligjit. Fakti i të qenit fëmijë i lindur jashtë martese nuk gjen pasqyrim në mënyrë të drejtëpërdrejtë në aktet e gjendjes civile të fëmijës, me qëllim që të mos krijojë kushte për diskriminimin e tij.

Sipas nenit 170, të Kodit të Familjes: “Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur jashtë martese mund të vendosen me anë të njohjes vullnetare ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor...”. **Përcaktimi i amësisë së fëmijës së lindur jashtë martese është i lidhur me qëndrimin e nënës dhe vullnetin e saj për të përmbushur me saktësi procedurat e**

nevojshme administrative, të nevojshme për përpilimin e dokumenti bazë të lindjes dhe të aktit të lindjes.

Me përfundimin e përpilimit të aktit të lindjes së një fëmije dhe me regjistrimin e tij në regjistrin themeltar të shtetasve me amësi të panjohur ose kur kalon afati 45 ditor i parashikuar nga ligji “Për gjendjen civile”, për deklarimin e lindjes dhe për regjistrimin e tij, si dhe kur fëmija mbetet i paregjistruar, nënës nuk i humbet e drejta për ta njohur atë fëmijë dhe për ti vendosur atij emrin e vet si amësi. Për të realizuar njohjen e saj si nënë e një fëmije të regjistruar me nënë të panjohur, ose të paregjistruar ende, Kodi i Familjes, në nenet 169, 170, 176 i ka njohur nënës për së gjalli, dy rrugë:

- rrugën administrative nëpërmjet deklarimit deklarimit vullnetar përpara nëpunësit të gjendjes civile

- nëpërmjet rrugës gjyqësore.

Sipas nenit 181, të Kodi të Familjes: “Atë i fëmijës së lindur jashtë martesë është personi madhor që e njeh si fëmijën e vet”. Zhvillimet shkencore në fushën e shëndetësisë si inseminimi artificial, nxjerrin nevojën jo vetëm të rregullimit ligjor sa më të detajuar, lidhur me mënyrat e përdorimit të këtyre zbulimeve shkencore në favor të shtetasve por edhe për mënyrat e përdorimit të tyre si fakte e prova në procesin e përcaktimit ose të vërtetimit të amësisë dhe të atësisë së një fëmije të regjistruar pa amësi e atësi, të atyre të lindur jashtë martesë, si dhe për kundërshtimin e tyre.

A do të konsiderohen fëmijët H. M. dhe A. M., fëmijë të lindur nga një martesë? Sigurisht që jo! Në këto rrethana, kur legjislacioni ynë i familjes në të dhënat që përbëjnë identitetin e personit dhe që shërbejnë për të krijuar statusin e tij vetjak, njeh “amësinë” - në numrin njëjës dhe “atësinë” - në numrin njëjës dhe kur jemi në kushtet e konceptimit dhe të lindjes së dy fëmijëve mbi bazën e metodave të riprodhimit mjekësor të asistuar, kërkesa e parashtruar nga paditëset do të refuzohej nga ana punonjësit të zyrës përkatëse të gjendjes civile.

- A përbën pengesë legjislacioni ynë në fuqi për regjistrimin e Hemës dhe A.s, me prindin/prindët e njohur si të tillë nga ligji? Mendojme që jo.

Sikurse është cituar më lart, përcaktimi i amësisë së fëmijës së lindur jashtë martesë është i lidhur me qëndrimin e nënës dhe vullnetin e saj për të përmbushur me saktësi procedurat e nevojshme administrative, të nevojshme për përpilimin e dokumentit bazë të lindjes dhe të aktit të lindjes. Pamundësia për të regjistruar “dy amësinë”, nuk do të thotë se, ligji nuk mundëson kryerjen e veprimit administrativ për regjistrimin në regjistrin e gjendjes civile të fëmijëve të sapolindur, përkatësisht H. dhe A. M., me njohjen dhe regjistrimin e nënës së tyre biologjike (E. M.), duke mos deklaruar atësinë së tyre. Cilët janë prindët e fëmijës dhe a e mohon faktikisht refuzimi i kryer nga ana e punonjësit të gjendjes civile, përkujdesjen prindërore? Diskutimi do të duhej të ndahej në dy aspekte, si gjendje fakti të dyja paditëset mund të ushtrojnë “de fakto” prindërim, sidomos kjo, për paditësen që nuk është nëna biologjike. Si një gjendje juridike, prindërimi për paditësen që nuk është nëna biologjike e fëmijëve është një çështje që nuk njihet si një e drejtë e tillë, në këto rrethana. Kjo gjë është e qartë edhe për vet paditëset kur ato shprehen se kjo gjë ndodh: “...për shkak të mungesës së parashikimeve ligjore për njohjen e familjeve dhe të prindërve të së njëjtës gjini”. A bie kjo ndesh me Kushtetutën dhe parimin e mbrojtjes së veçantë që duhet të gëzojnë nga shteti fëmijët dhe nënat e reja? Mendojme që ndonese ne pamje te pare duket se jo, kjo ceshtje ka nevoje te trajtohet me gjeresisht dhe duhet te krijoje balanca te reja dhe me gjithperfshirese ne shoqerine tone. Te drejtat e bebeve qartesisht mbrohen me mire nese ato kane lidhje familjare per shkak te ligjit me 2 prinder sesa vetem nje prind, e konkretisht ate te lidhjes se sigurte te gjakut qe eshte nena biologjike. Ky parim

eshte balancuar per femijet qe lindin gjate marteses (duke iu prezumuar atesia), apo edhe atyre te lindin per nje afat te caktuar kohor pas zgjidhjes se marteses duke prezumuar si at, ish bashkeshortin e nenes. Keto parashikime ne kod kane qellim mirrerrritjen e femijes dhe interesin e tij me te larte, qe te kete kujdesje prinderore nga dy prinder pasi kjo gje perben per ta nje garanci te shtuar per jeten e tyre aktuale por edhe ne te ardhjen. Ndersa, dy paditeset kane qene apo jane koshiente e lidhje me te drejtat e detyrimet e tyre apo e dhe me rrezikun potencial te nje menyre jetese e cila nuk mund te formalizohet sipas legjislacionit aktual ne fuqi, e njejta gje nuk eshte e vertete per te miturat Amara dhe H. per sa ato kane te drejte tu garantohet edhe ligjierisht lidhja me partneren e nenes si kontribuese ne mirrerrritjen e tyre persa ajo e kerkon nje gje te tille.

A do të konsiderohet i mirëqënë fakti se paditëset kanë sjellë në jetë fëmijë? Kjo është një tezë e debatueshme, në kontekstin e gjithë tablosë së kësaj çështjeje. Aktualisht dhe faktikisht fëmijët janë sjellë në jetë nga nëna e tyre biologjike, me anë të metodave të riprodhimit artificial. Ky fakt nuk do të ndryshonte edhe nëse shtetasja E. M., nuk do të ishte në një lidhje afektive me një person tjetër të së njëjtës gjini, ama për të qene ai kontribues e bashkepergjegjes për bebet do të mjaftonte vetëm deklarimi i tij në gjendjen civile, pa pasur nevojën e ndonjë formalitetit tjetër.

- *Në kërkesë-padinë e tyre, paditëset shprehën se, megjithëse Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (neni 12), si dhe **Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë** (neni 7 dhe neni 163), e lidhin konceptin e martesës por edhe të bashkëjetesës në mënyrë të drejtëpërdrejtë me bashkim mes një burri dhe një gruaje, **Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut** e ka orientuar çështjen drejt parimit të subsidiaritetit duke sugjeruar një interpretim evolutiv të Konventës dhe duke ju referuar legjislacioneve të brendshme të vendeve të Këshillit të Europës, që kanë pranuar në legjislacionet e tyre të brendshme bashkime të tilla.*

Pa dashur të paragjykojmë, duket sikur mundësia apo kërkesa për të gëzuar të drejtën për të pasur një jetë familjare nga ana e dy paditëseve që kërkojnë që të regjistrohen njëkohësisht në gjendjen civile si nëna, të dy vajzave të sapolindura, po vendos në balance interesin më të lartë të fëmijës për tu regjistruar në regjistrin e gjendjes civile, qoftë edhe vetëm me njohjen e prejardhjes nga nëna e tyre biologjike. Fakti që fëmija i porsalindur përfaqësohet në këto procedura nga prindët e tij, sipas kuptimit të dhënë ligjor për prindin në këtë rast, nuk mundet që t'i japë prindit (nënës biologjike) të drejtën për të mbivendosur dhe dhënë përparësi, realizimit të qëllimit të bashkëjetesës me një person tjetër, qoftë edhe i të njëjtit seks, ndaj interesit më të lartë të fëmijës që lidhet me të drejtën e fëmijës për regjistrim menjëherë pas lindjes, nga ana e prindit/prindërve, apo personave të tjerë të autorizuar nga ligji, brenda afateve ligjore.

Ky konkluzion është edhe më i dukshëm po të kemi parasysh faktin se, nëna biologjike e të dy fëmijëve të porsalindur e ka të qartë dhe ka dijeni të plotë se legjislacioni aktual në fuqi, në vendin tone, nuk njeh bashkëjetesën faktike mes personave të të njëjtit seks dhe për më tepër, si prindër njeh dy individë, të cilët për nga përkatësia heteroseksuale gëzojnë cilësinë e “amësisë” dhe të “atësisë”.

Në këtë kuptim të drejtat ligjore të prindërve duhet të trajtohen në mënyrë të balancuar me të drejtat ligjore të fëmijëve dhe duhet bërë kujdes në prioritetin e të drejtave të fëmijëve. Kjo lidhet me zbatimin e drejtë të parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Ndërhyrjet legislative ne kete rast duhet të bëhen duke respektuar dy parime, njëkohësisht dy të drejta të rëndësishme:

- *Respektimi i së drejtës së prindërve për të pasur fëmijë,*
- *Respektimi i të drejtave, interesave dhe mirëqënies së fëmijës por edhe për të pasur prinder ne menyre qe tu garantohet me mire jeta ne tyre ne vijimsi deri sa te behen madhore.*

ku grupimi i dytë mund të konsiderohet më i rëndësishmi, së paku në këtë rast.

Edhe në kontekstin e legjislacionit familjar, në fuqi, në Republikën e Shqipërisë, pranohet se nuk mund të respektohet e drejta e prindërve për të pasur fëmijë, duke shkelur parimet dhe të drejtat e fëmijëve, pasi teknikat riprodhuese do të përkeqësonin jetët njerëzore shumë më shumë se sa do të “kënaqnin”, prindërit në pasjen e fëmijëve.

A duhet domosdoshmërisht që regjistrimi i fëmijës së porsalindur të lidhet detyrimisht edhe me njohjen e detyruar të “dy amësisë”, sikurse kërkohet nga ana e paditëseve?

Mendojme që në rastin objekt gjykimi, pavarësisht të drejtës dhe mundësive të barabarta që duhet tu japë shoqëria jonë femijeve për të pasur 2 prindër, interesat e tyre do të ishin të mbrojtura më mirë duke bërë regjistrimin e tyre në formën që është e mundur dhe duke kundërshtuar atë pjesërisht vetëm në lidhje me mosgarantimin e regjistrimit si familje për shkak të ligjit edhe të partneres së nënës biologjike. Është e rëndësishme që në këtë konsiderim të vendoset një raport i drejtë ndërmjet të drejtave të fëmijës, (interesit më të lartë të fëmijës), të drejtës prindërore të nënës biologjike dhe interesave të ligjshëm të individëve që synojnë krijimin e një familjeje, jete familjare dhe marrëdhënieje familjare.

Legjislacioni ynë i familjes nuk lejon regjistrimin e dy nënave si prindër të një fëmije në regjistrin e gjendjes civile, ndaj në këtë kontekst duhet mbajtur parasysh edhe fakti se gjykata nuk krijon normë të re, por interpreton dhe zbaton legjislacionin në fuqi, përkatës, për rregullimin e çështjes në gjykim. Në këtë kontekst mendojmë se qasja duke u nisur nga gjinia në lidhjet familjare duhet të rivlerësohet në shoqërinë tonë për të përfshirë në të edhe realitetet e personave të cilët nuk do të donin të identifikonin në regjister indentitetin tyre gjinor në marrëdhënie me fëmijën. Përfshirja e mundësisë për tu identifikuar pa specifikuar gjininë, por vetëm me fjalën prind është një e drejtë e cila vë theksin në realitetin afektiv që krijojnë anëtarët e një familjeje ligjore apo familje fakti me fëmijët dhe me afekcionin e detyrimet që ata marrin përsipër ndaj femijes. Shoqëria jonë ka evolur dhe si edhe e thame me lart në evoluimin e konceptimit të femije, prindit, prinderimit dhe përgjegjësisë për mirërritjen e tyre duke marrë përsipër shteti mirërritjen kur nuk i kanë prindrit apo kur prindërit nuk i mirërisin dot. Nderkohe, në rastin objekt gjykimi, shoqëria shqiptare, për një artific rrezikon tua garantoje kete te drejte bebeve Amara dhe H.

Përfshirja e çifteve të të njëjtit seks nga statusi martesor (e drejta për martesë) apo edhe e drejta për bashkëjetesë faktike nga Kodi i Familjes, i përjashton ata gjithashtu edhe nga të gjitha ato të drejta dhe përgjegjësi, që vijnë ekskluzivisht me qënien e martuar, apo edhe në bashkëjetesë faktike.

- ***Vlerësime të tjera të përgjithshme***

Dy paditëset kanë kërkuar nga ana e gjykatës, ndryshimin e aktit administrativ, përkatësisht të shkresës nr.2627/1 datë 15.04.2021, nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr.2, Tiranë, dhe detyrimin e kësaj zyre për të regjistruar fëmijët H.

dhe A. M., binjake, të lindura në datën 18.01.2021 dhe për të regjistruar si nëna paditëset A. A. dhe E. M., me të drejta amësie, në të njëjtën përbërje familjare.

Ajo që duhet nënvizuar është fakti se, refuzimi që ka ndodhur nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr.2, Tiranë, bazohet në përcaktimet e ligjit “Për gjendjen civile”, i cili në dispozitat e tij nuk prezanton një rregullim të shkëputur dhe fragmentar të instituteve të parashikuara dhe të rregulluara në tërësi, në të drejtën tonë familjare. Këtu bëhet fjalë për një korpus ligjor që në tërësi parashikon dhe rregullon këto institute. Pra, nëse do supozonim për një çast se ligji “Për gjendjen civile”, shkel të drejta të ligjshme të paditëseve, do të duhej të supozonim që i gjithë ky korpus ligjor gjendet në të njëjtën situatë shkeljeje.

Çështja në fjalë duhet analizuar në konsiderimin e të drejtave ligjore që realisht gëzojnë sot çiftet “e të njëjtit seks”. Pa dyshim që nëpërmjet institutit të martesës, e drejta familjare në shumë vende të vendeve europiane, sikundër edhe në vendin tonë, i ka dhënë të drejta dhe përgjegjësi çifteve heteroseksuale. Duke përjashtuar çiftet e të njëjtit seks nga statusi martesor (e drejta për martesë), ata janë përjashtuar gjithashtu edhe nga të gjitha ato të drejta dhe përgjegjësi, që vijnë ekskluzivisht me qënien e martuar.

Tendenca e shfaqur në vendet europiane këto vitet e fundit ka qënë që, ky lloj përjashtimi të reduktohet dhe nga njëra anë kjo është bërë duke i ofruar çifteve të të njëjtit seks mundësinë për të formalizuar marrëdhënien e tyre në martesë, ose së paku si një partneritet i regjistruar. Nga ana tjetër, gjithnjë e më shumë të drejta po i jepen çifteve të të njëjtit seks, të cilët jetojnë së bashku në një bashkëjetesë informale dhe/apo të cilët formalizojnë marrëdhënien e tyre (duke u martuar me njëri-tjetrin, ose duke regjistruar partneritetin e tyre). Këto zhvillime kanë gjetur vend fillimisht në legjislacionin e brendshëm të vendeve europiane por edhe e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe e drejta e Bashkimit Europian kanë luajtur rolin e tyre.

Tendenca e vërejtur në vendet europiane është se, njohja e martesës për çiftet e të njëjtit seks vjen thuajse gjithmonë, pas njohjes së regjistrimit të partneritetit të çifteve të të njëjtit seks. Ndërkohë në shumë vende ku për çiftet e të njëjtit seks fituan të drejtën e statusit familjar (partneritet i regjistruar apo martesë), para se të ndodhte kjo, disa të drejta u ishin njohur çifteve të të njëjtit seks që bashkëjetonin në mënyrë informale. Kjo do të thotë se, veç “Partneritetit para martesë” gjithashtu edhe “të drejtat para statusit”, janë një sekuencë tipike në procesin e njohjes ligjore të çifteve të të njëjtit në vendet europiane. Për çiftet e të njëjtit seks, të drejtat dhe përgjegjësitë, janë njohur shpesh para statusit formal dhe këto të drejta dhe përgjegjësi tregojnë më shumë rreth gjendjes juridike faktike të dikujt, se sa statusi martesor apo ndonjë status tjetër i njohur, nëpërmjet të cilit ato njihen si të tilla.

Pyetja që shtrohet është se, cilat të drejta dhe përgjegjësi vijnë në radhë të parë tipikisht? Nga një punim shkencor i botuar nga ana e “European Studies of Population”,⁹ mbi këto çështje, konstatohet se grupimi i të drejtave dhe përgjegjësi që u janë njohur në këto rrethana çifteve të të njëjtit seks (mbi bazën e përcaktimit: “same-sex legal recognition consensus”), janë të drejtat e njohura ndryshe, si “të drejtat e kohëve të trishta” dhe që lidhen me situatat kur një nga partnerët vdes (vazhdimi i marrëdhënies së qirasë,

⁹ European studies Population, 24, “Same-Sex families and the legal recognition in Europe”, - “What first, what later? Patterns in the legal recognition of same-sex partners in European countries”, author Kees Waaldijk, faqe 11-44; https://doi.org/10.1007/978-3-030-37054-1_2

kompensimi për vdekje të gabuar, pensioni familjar, trashëgimia, përjashtimi nga taksa e trashëgimisë), apo kur një nga partnerët goditet rëndë “nga kohë të këqija”, (aksident, sëmundje, dhunë familjare, procedim penal, divorc). Të drejta të tjera të njohura por tashmë që lidhen me konceptin e “kohëve të mira”, kanë të bëjnë me mbajtjen e emërit të përbashkët apo të shtetësisë së përbashkët, ndarjes së pasurive apo avantazheve të taksës, ndarjes së përgjegjësive për fëmijët.

Duke iu referuar këtij punimi, shohim se inseminimi mjekësor i asistuar dhe mënyrat e ndryshme që një fëmijë të ketë dy prindër legalë të të njëjtit seks janë edhe më të debatueshme si të drejta. Sidoqoftë tani duket se ka një konsensus më të afërt sa i takon së paku, lejimit të partnerëve të të njëjtit seks për të marrë disa përgjegjësi për fëmijët e njëri-tjetrit. Për më tepër, çështjet rreth lejes prindërore dhe rreth autoritetit prindëror erdhën në pah vetëm për situatën ku vetëm një prej dy partnerëve është prindi ligjor i fëmijës. Tre të drejtat prindërore që nuk involvojnë statusin ligjor të prindit (si leja prindërore, autoriteti prindëror, dhe inseminimi i asistuar), janë më së shumti mes të drejtave parësore të prindërimit që iu dhanë çifteve të të njëjtit seks, edhe para njohjes së partneritetit të regjistruar. Në disa vende, si Greqia, Irlanda, Holanda, dhe Britania e Madhe, kjo filloi me mosndalimin e inseminimit të asistuar mjekësor të gruas, në marrëdhënie të të njëjtit seks.

Sipas studimit të sipërcituar, në procesin e njohjes ligjore të të drejtave dhe përgjegjësive të çifteve të të njëjtit seks, mund të dallohen 5 sequenca tipike që karakterizojnë këtë proces në vazhdim:

- Të drejtat para statusit
- Partneritet para martese
- Të drejtat e kohëve të trishta para të drejtave të kohëve të mira
- Të drejtat e partnerit individual para të drejtave të çiftit
- Përgjegjësitë para përfitimeve

Sipas kësaj skeme, theksohet se njohja ligjore e familjeve të të njëjtit seks, nuk erdhi vetëm kur u njoh një formë partneriteti e regjistruar për çiftet e të njëjtit seks, apo kur u njoh martesa për ta, por gjithashtu edhe në periudhën para gjithë kësaj, në periudhën midis këtyre dy momenteve, apo edhe pas gjithë kësaj. Kështu që shpesh, të drejtat dhe përgjegjësitë për partnerët e të njëjtit seks erdhën dhe u njohën gjatë pesë periudhave.

Në një grup të caktuar vendesh europiane, duke filluar me Hollandën, Suedinë, Belgjikën, Irlandën, Finlandën, Greqinë, etj, është ligjërish e mundshme për një grua në marrëdhënie të të njëjtit seks që të mbetet shtatzënë përmes inseminimit mjekësor të asistuar. Rezultati është se, në më të shumtën e këtyre vendeve, çiftet e të njëjtit seks janë lejuar tashmë që të krijojnë një familje me fëmijë dhe të formalizojnë marrëdhënien e tyre me këta fëmijë. Në vitin 2003, Suedia u bë i pari vend evropian ku, kur një grua lind një fëmijë, partnerja e saj femër mundet gjithashtu të bëhet prind ligjor i këtij fëmije nga momenti i lindjes. Një mundësi e tillë eksiton tani në një pakicë jo të vogël të vendeve europiane. Njohja e këtyre të drejtave nëpërmjet legjislacionit të familjes nuk nxjerrin në pah vetëm faktin e rëndësisë së legjislacionit përtej qënies simbolikisht i rëndësishëm por në këtë rast legjislacioni bëhet praktikisht i rëndësishëm për jetët e personave në fjalë.

Politikisht, hyrja në fuqi e ligjeve shihet shpesh si fundi i një procesi, por gjetjet sociologjike të fushës na bëjnë të ndërgjegjshëm se, ligjet shpesh janë vetëm një “hap i parë” në një proces social dhe thelbësor për fillimin e përfshirjes sociale.

Qoftë praktike apo simbolike, rëndësia sociale e njohjes ligjore të jetës familjare të çifteve me të njëjtin seks, tanimë njihet si e tillë edhe në të drejtën Europiane. Shumë rregullore të BE-së tani referojnë tek partneriteti i regjistruar, partnerët jo martesorë, personat që jetojnë në një marrëdhënie të përkushtuar intime etj, ndërkohë që si Gjykata e Drejtësisë të BE-së dhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut kanë njohur këtë ndryshim ndërmjet partnerëve të të njëjtit seks dhe partnerëve të sekseve të ndryshme, të përmbledhur në diskriminimin me orientim seksual. Së fundmi, gjykata ka shprehur se partneritetet jo martesore mbulohen gjithashtu nga e drejta për të respektuar “jetën familjare” dhe se kjo përfshin edhe partneritetet e të njëjtit seks. Gjykata është shprehur gjithashtu se, për një çift të të njëjtit seks “një alternativë zyrtare e njohur për martesë ka një vlerë të brendshme”, veç efektit të saj ligjor,¹⁰ dhe se, një njohje e tillë do të sillte në vazhdim “një sens legjitimiteti tek çiftet e të njëjtit seks”¹¹.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, ka folur në mënyrë të përsëritur rreth “të drejtave thelbësore të një çifti në një marrëdhënie të përkushtuar e të qëndrueshme”.¹² Dhe gjykata ka treguar në shumë raste se konsiderimi i qënies apo jo si kufizim, apo nëse përjashtimi apo dallimi është i justifikuar sipas Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, kjo gjë do të shihej në studimet krakahsuese të situatës në vendet anëtare të Këshillit të Europës.¹³

Ndoshta në disa vende është ende shumë e vështirë për të menduar për një gjë të tillë, jashtë kontekstit të martesës. Njohja ligjore e partnerëve të të njëjtit seks është thuarje gjithmonë një proces. Dhe ky proces duhet që të fillojë nga diku. Para dhe në fillim të këtij procesi, vendet janë tipikisht hezituese për të përfshirë çiftet e të njëjtit seks në të drejtat dhe përgjegjësitë që vijnë nga martesat e çifteve heteroseksuale. Kjo nxjerr nevojën e një luftë të gjatë ligjore dhe politike. Sidoqoftë, një njohje fillestare ligjore mund tashmë që të ketë një efekt pozitiv në qëndrimet sociale dhe në legjitimitetin social, të familjeve të të njëjtit seks.

Gjykata e Strasburgut ka pasur rastin që të specifikojë në këtë kontekst se, “anëtarët e familjes”, janë në çdo rast ata të përmendur në nenin 2(2) të Direktivës 2004/38.¹⁴

¹⁰ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, Vallianatos v. Greece, 7 November 2013, 29381/09 & 32684/09, paragraph 81.

¹¹ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, Oliari v. Italy, 21 July 2015, 18766/11 & 36030/11, paragraph 174.

¹² Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, Oliari v. Italy, 21 July 2015, 18766/11 & 36030/11, paragraph 172, 174, 185.

¹³ Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, X and Others v. Austria, 19 February 2013, paragraph 54.

¹⁴ Në nenin 2/2 të direktivës thuhet se: “Për qëllime të kësaj direktive;

2. Anëtarë të familjes janë:

- e) Bashkëshortja
- f) Partneri me të cilin shtetasi i Unionit ka lidhur një partneritet të regjistruar, mbi bazën e legjislacionit të një Vendi Anëtar, nëse legjislacioni i Vedit Anëtar mikpritës i trajton partneritetet e regjistruara si ekuivalente me martesën dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin përkatës të Vedit Anëtar mikpritës.
- g) Pasardhësit direkt të cilët janë nën moshën 21 vjeç apo janë nën përkujdesje dhe ata të bashkëshortes apo partnerit siç përcaktohet në pikën (b),
- h) Të afërm të drejtëpërdrejtë të varur në linjën zbritëse dhe ato të bashkëshortes apo partnerit siç përcaktohet në pikën (b)”.

Duam të sjellim në vëmendje edhe një herë konstatimet e nxjerra në opinionin “Amicus Curiae” të Avokatit të Përgjithshëm Kokott, për Çështjen C-490-20, Case C-2/21, Rzecznik Praw Obywatelskich.

Aktualisht nuk ka konsensus brenda Bashkimit Europian mbi parakushtet për akses në institucionet themelore të së drejtës së familjes. Ligjet kombëtare që rregullojnë martesën (apo divorcin) dhe prejardhjen (apo edhe riprodhimin) përcaktojnë marrëdhëniet familjare që qëndrojnë në zemër të kësaj fushe. Sa i takon martesës, vetëm 13 nga 27 vendet anëtare të BE-së, kanë tashmë, zgjeruar këtë institut për çiftet e së njëjtit seks. Për më tepër, prej këtyre 13 shteteve anëtare, vetëm disa ofrojnë prindërimin “automatik”, të gruas së nënës biologjike të një fëmije.

E drejta familjare është një fushë sensitive ligjore që karakterizohet nga një pluralitet konceptesh dhe vlerash në nivel të shteteve anëtare dhe të shoqërive brenda tyre. E drejta familjare - qoftë e bazuar në vlerat tradicionale apo më shumë në vlerat “moderne” - është shprehja e imazhit të shtetit në të dyja nivelet politike dhe sociale. Mund të bazohet në ide religjioze, apo të shënojë heqjen dorë nga këto ide nga shteti në fjalë. Për këtë qëllim, sidoqoftë, në çdo rast është një shprehje e identitetit kombëtar të jetësuar në strukturat themelore politike dhe konstitucionale.

Për më tepër, rregullat që përcaktojnë marrëdhëniet familjare janë të rëndësie shumë të madhe për funksionimin e komunitetit shtetëror në përgjithësi. Kështu që, kur një shtet aplikon principin e “ius sanguinis”, në këtë kuptim, prejardhja e një personi përcakton kombësinë (shtetësinë) dhe kështu vetë faktin se, një person i përket një shteti të caktuar. Përkufizimi ligjor se çfarë është një familje apo një prej anëtarëve të saj, ndikon kështu strukturën themelore të shoqërisë.

Hapa të mëdha janë bërë përpara dhe situata ka evoluar ndjeshëm në lidhje me të drejtat e personave LGBTIQ por edhe fëmijëve të tyre¹⁵. Është e qartë që një pjesë e fëmijëve vuajnë diskriminim të tërthortë për shkak të orientimit seksual të prindërve të tyre. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka miratuar një rezolutë me anë të së cilës u kërkohet vendeve anëtare të Këshillit të Evropës të punojnë për të përshtatur legjislacionet e brendshme për të mënjanuar diskriminimin si të personave LGBTIQ ashtu edhe të familjeve të tyre.

- Propozime për të paraprirë situata te tilla :

- *Propozimi për fillimin e procesit të njohjes ligjore të të drejtave dhe përgjegjësiive prindërore të çifteve të të njëjtit seks, përfshirë të drejtën, e regjistrimit të partneres femër të gruas që lind fëmijë më insemimin artificial, si prind ligjor i këtij fëmije nga momenti i lindjes së tij/saj.*
- *Ndryshimi i legjislacionit që do të njohë martesat për çiftet e të njëjtit seks dhe të regjistrimit të partneritetit (bashkëjetesës) të çifteve të të njëjtit seks.¹⁶*

¹⁵, [Resolution 2239 \(2018\)](#): Private and family life: achieving equality regardless of sexual orientation (and its [Report, Doc. 14620](#))

¹⁶ Në dokumentin e Agjencisë së Bashkimit Europian për të Drejtat Themelore (FRA), “**Contribution of the European Union Agency for Fundamental Rights (FRA) to the “follow-up to the Committee of Ministers’ Recommendation CM/Rec (2010) 5 on measures to combat discrimination on grounds of sexual orientation or gender identity”, lidhur me “Right to respect for private and family life”, gjendet opinion se:** “5. In relevant areas of EU law, in particular employment related partner benefits, free movement of EU citizens, and family reunification of refugees and third country nationals, EU institutions and Member States should consider explicitly incorporating same-sex partners, whether married, registered,

- **Vënia në lëvizje e gjykatës Kushtetuese:**

Në nenin “49, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, parashikohen subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Sipas kësaj dispozite ligjore:

1. Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare e kanë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Popullit. “

2. Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin vetëm të respektimit të procedurës së parashikuar nga Kushtetuta, sipas nenit 131, pika 2, dhe nenit 177, të Kushtetutës, e kanë Presidenti i Republikës dhe jo më pak se një e pesta e deputetëve.

3. Të drejtën për të filluar një kontroll mbi pajtueshmërinë e ligjit ose akteve të tjera normative me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare e kanë edhe:

a) Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;

b) organet e qeverisjes vendore, kur pretendojnë se u janë cenuar të drejtat e tyre të parashikuara në Kushtetutë ose pozita e tyre kushtetuese;

c) komisionerët e krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, kur gjatë veprimtarisë së tyre konstatojnë se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve;

ç) Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë kushtetuese të tyre, ose pozitën juridike të gjyqtarëve dhe të prokurorëve;

d) organet e bashkësive fetare, partitë politike, organizatat, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë e tyre dhe të drejtat dhe liritë e anëtarëve të tyre;

dh) gjykatat e të gjitha niveleve, kur gjatë gjykimit të një çështjeje konstatojnë se ligji ose akti normativ bie ndesh me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare;

e) individët, kur pretendojnë se u cenohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale të drejtat dhe liritë e tyre të parashikuara në Kushtetutë, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për këtë qëllim, si dhe kur akti që kundërshtojnë është drejtpërdrejt i zbatueshëm dhe nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e tij.

4. Subjektet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, kanë detyrimin të provojnë në çdo rast se çështja lidhet drejtpërdrejtë me të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta ose me qëllimet e veprimtarisë së tyre”.

Afati për paraqitjen e një kërkesë të tillë nga ana e gjykatës që ushtron të drejtën e shqyrtimit incidental, parashikohet në nenin 50, të po këtij ligji, ku thuhet se:

“1. Kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, sipas pikës 1 dhe pikës 3, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të nenit 49, të këtij ligji, mund të paraqiten brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit.

2. Kërkesat për kushtetutshmërinë e ligjit për rishikimin e Kushtetutës, në aspektin procedural, mund të paraqiten brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit.

3. Gjykatat mund ta paraqesin kërkesën në çdo kohë, kur gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore konkrete, sipas nenit 145, pika 2, të Kushtetutës, çmojnë antikushtetutshmërinë e ligjit ose të aktit normativ.

or in de facto in union, within the definitions of “Family member”. In particular in the context of the free movement, this could be achieved explicitly adopting “the country of origin” principle already firmly established in other areas of EU law”.

4. Individët mund të paraqesin kërkesë për papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara brenda 4 muajve nga konstatimi i cënimit”.

Në vazhdim neni 68 i ligjit, bën një detajim të kësaj të drejte që kanë gjykatat, duke parashikuar shprehimisht se:

“1. Kur gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor dhe në çdo kohë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, çmon se ligji është antikushtetues dhe kur ka lidhje të drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk e zbaton atë, duke vendosur pezullimin e shqyrtimit të mëtejshëm të çështjes dhe dërgimin e materialeve të saj Gjykatës Kushtetuese, për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e ligjit.

2. Në vendimin e saj gjykata apo gjyqtari duhet të përcaktojë dispozitat e ligjit që ata çmojnë se janë të papajtueshme me normat konkrete ose parimet e tjera të Kushtetutës, të cilat ligji nuk i ka respektuar ose i ka cënuar, si dhe shkaqet për të cilat kërkohet shfuqizimi i tij”.

Pas parashtrimit të sa më sipër, natyrshëm shtrohet pyetja: Cila është e drejta themelore e shkelur në kontekstin e legjislacionit të familjes, në Republikën e Shqipërisë dhe cili ligj apo akt normativ e shkel atë në parashikimet e tij, në këtë rast? Në vlerësimin tonë, mendojmë se legjislacioni aktual në fuqi e shkel të drejtën e pretenduar të krijimit të marrëdhënieve të amësisë. Ai shkel gjithashtu edhe të drejtën e fëmijëve H. e Amara për të pasur një prind ligjor krahas nënës biologjike. Legjislacioni ynë në evolucion të drejtave të fëmijës apo edhe njeriut ka pranuar në parim të drejtën e një fëmije për tu rritur në një familje dhe ua garanton atyre të drejtën me anë prezumimit për të pasur baba ligjor, apo edhe familje birësuese, apo prind birësues. Fëmijët e lindur me inseminim nga një nënë e vetme me partere femër, nuk përfitojnë të njëjtin garanci e nën këtë këndvështrim mendojmë se ka nevojë për të pasur një gjykim incidental në lidhje me këtë çështje, si përsa i përket të drejtës për të pasur kujdesin e prindit ligjor, ashtu edhe trajtimin të barabartë të fëmijëve me specifikat e paditëseve H. dhe Amara në krahasim me çdo fëmijë tjetër të lindur me apo pa baba biologjik.

Edhe duke iu referuar të drejtës për jetë familjare, respektimin e saj si dhe një kontekst diskriminimi në trajtimin e çifteve të të njëjtit seks, jemi të mendimit se Gjykata e Strasburgut ka një vlerësim dinamik ende në proces lidhur me këto çështje, sa i takon respektimit të nenit 8 dhe nenit 14, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Referuar specifikës së rastit që kemi analizuar, jemi të mendimit se, vendimi që do të nxjerrë kjo gjykatë për Çështjen C-490-20, Case C-2/21, Rzecnik Praw Obywatelskich, do të jetë një “gur kilometrik” referues edhe për gjykatat në vendin tonë.

Në vlerësimin e kësaj çështjeje, gjykata do të duhet që përballë argumenteve të paditësve që kërkojnë në thelb pranimin e realiteteve të reja sociale, të vendosë përballë argumentet e interesit publik në një shoqëri demokratike dhe të konsiderojë gjetjen e një balance të drejtë dhe proporcionale mes tyre. Ne mendojmë se ka nevojë për një interpretim evolutiv të të drejtave të fëmijës për të garantuar ato në mënyrë efektive.

Erinda BALLANCA